


Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës
Младитски совет на Општина Кичево
Youth Council of the Municipality of Kercova



Komuna e Kërçovës
Општина Кичево

STRATEGJIA

rinore e Komunës së Kërçovës
2017 - 2022



osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

STRATEGJIA RINORE E
KOMUNËS SË KËRÇOVËS
2017 - 2022

Autorë: Sanja Bozhoviç
Florin Rexhepi

Anëtarë të Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës:

Arben Ristemi
Salije Sadiku
Ivana Lazeska
Albiona Demiri
Gazmend Ukalli
Margaritare Ballazhi
Dejan Gjurçevski
Muhamed Mamudoski
Ivana Lazeska
Nuredin Sulejmanoski
Liridon Zenku

2

Përkthyes: Florin Rexhepi

Lektor: Fatlume Adili

Fatlume Adili: *Misioni i OSBE-së në Shkup:
Mirije Sulmati
Jasmina Todorovska Miteva*

Shtypi: Poliesterdej

osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Përbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimin apo qëndrimin e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC.DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së.



Të rinjtë janë pasuria më e madhe e një populli, liderët e së nesërme dhe shpresa për një ardhmëri më të mirë. Rinia aktive mund ta përforcojë demokracinë, ta adresojë pabarazinë dhe të kontribuojë për një zhvillim shoqëror të qëndrueshëm. Me pjesëmarrjen e të rinjve sukcesi është i pashmangshëm.

Kjo strategji u përgatit nga të rinjtë që janë pjesë e Këshillit Rinor dhe pikërisht kjo e bën atë të posaçme për ne. Ajo do të shërbejë si udhërrëfyese ynë për zhvillimin dhe përkrahjen e projekteve në dobi të të rinjve. Krijimi i mundësive për zhvillimin personal të të rinjve dhe përfshirja aktive e të rinjve në avancimin e jetës shoqërore në komunën tonë do të vazhdojë të jetë në fokus të punës sonë.

A handwritten signature in black ink, which appears to be 'Fatmir Dehari'.

Komuna e Kërçovës
Kryetar,
Fatmir Dehari

Para jush është Strategjia rinore e Komunës së Kërçovës, e cila synon avancimin e pozitës së të rinjve si dhe zbatimin e të drejtave të tyre në këtë komunë. Kjo strategji rinore është punuar në bashkëpunim me organizatat rinore, të rinjtë si dhe palët e tjera të interesit në Komunën e Kërçovës. Me këtë dokumenti përfaqësimi do të krijohen përcaktimet strategjike dhe afatgjata të Komunës së Kërçovës dhe Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës, për të punuar për avancimin e çështjeve të rinisë dhe plotësimin e nevojave të të rinjve.

Vizioni i strategjisë rinore është të rinjtë e Komunës së Kërçovës të jenë pjesë e proceseve të vendimmarrjes në çdo nivel dhe në veçanti në vendimet e rëndësishme për ta, si dhe përfshirja e të gjithë të rinjve në zbatimin e aktiviteteve për realizimin e të drejtave të tyre. Kjo strategji duhet të mundësojë që të rinjtë të jenë të kënaqur me cilësinë e jetës që ofron Komuna e Kërçovës, si dhe të jenë partner i Komunës në përballimin e të gjitha sfidave.

PËRMBAJTJA

RRETH STRATEGJISË RINORE TË KOMUNËS SË KËRÇOVËS	6
TË RINJTË NË KOMUNËN E KËRÇOVËS.....	8
FUSHA: ARSIMI	11
PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E ARSIMIT.....	16
FUSHA: STANDARDI SOCIAL	17
PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E STANDARDIT SOCIAL.....	21
FUSHA: MIGRIMI	22
REKOMANDIME STRATEGJIKE NË FUSHËN E MIGRIMIT.....	25
FUSHA: SHËNDETËSIA DHE PARANDALIMI	26
PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE PARANDALIMIT.....	30
FUSHA: INTEGRIMI NDËRETNIK	31
PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E INTEGRIMIT NDËRETNIK.....	34
FUSHA: INFORMIMI I TË RINJVE	35
PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E INFORMIMIT TË TË RINJVE	38
FUSHA: PJESËMARRJA E TË RINJVE	39
PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E PJESËMARRJES SË TË RINJVE	42
FUSHA: URBANIZMI	43
PRIORITETI STRATEGJIK NË FUSHËN E URBANIZMIT.....	44
FUSHA: KULTURA	45
PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E KULTURËS	50
FUSHA: SPORTI	51
PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E SPORTIT	54
PARIMET E ZBATIMIT TË STRATEGJISË RINORE DHE TË PËRGATITJES SË PLANEVE TË VEPRIMIT	55
MONITORIMI DHE VLERËSIMI	57
LITERATURA	58

RRETH STRATEGJISË RINORE TË KOMUNËS SË KËRÇOVËS

Në fillim të vitit 2016 Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës dhe Komuna e Kërçovës, në bashkëpunim dhe me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Shkup, filluan të përgatisin strategjinë rinore të Komunës së Kërçovës. Në përgatitjen e saj u përfshinë të gjithë anëtarët e Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës.

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti ishte që Komuna dhe Këshilli Rinor të kenë një akses të koordinuar dhe të vazhdueshëm për zgjidhjen e problemeve dhe sfidave të të rinjve në nivel lokal, si dhe përfshirje më e gjerë të të rinjve në procesin e përgatitjes, zbatimit dhe vlerësimit të politikave rinore. Nëpërmjet kësaj strategjie rinore vihen në shënjestër të gjitha problemet e të rinjve të cilat Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës të cilat do të përpiqet t'i adresojë në periudhën e ardhshme dhe të kontribuojë njëkohësisht edhe për promovimin e qytetarisë aktive dhe të përgjegjshme të të rinjve dhe të sektorit rinor.

Çështjet që janë vënë në shënjestër si më të rëndësishme për t'u zgjidhur në periudhën e ardhshme janë caktuar me metodologji të posaçme, përkatësisht nëpërmjet zbatimit të pyetësorëve dhe analizës së të gjitha hulumtimeve dhe dokumenteve në nivel lokal dhe nacional. Për hartimin përkatës të pyetësorit të përdorur dhe për përzgjedhjen e fushave të përfshira në të, në fillim u analizuan dokumentet ekzistuese dhe relevante në vend, të cilat lidhen me çështjet dhe problemet e të rinjve. Pas analizës së bërë u përgatit pyetësori, qëllimi i të cilit ishte shqyrtimi i mendimit të të rinjve në Komunën e Kërçovës rreth temave të ndryshme për të identifikuar sfidat më të mëdha dhe çështjet më urgjente që duhet të zgjidhen në nivel lokal. Për këtë qëllim u realizuan 353 pyetësorë me të rinjtë në Komunën e Kërçovës, përfaqësues të sektorit civil, studentë si dhe nxënës të shkollave të mesme. Në këta pyetësorë u përfshinë të gjitha kategoritë dhe grup-moshat e reja që të merren informata përkatëse dhe udhëzime për punën e Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës. Pyetësorët u realizuan në tri gjuhët zyrtare të Komunës: në gjuhën maqedonase, në gjuhën shqipe dhe atë turke.

Pas realizimit të pyetësorëve dhe marrjes së përgjigjeve u organizuan konsultime publike me të gjitha palët e interesit për rezultatet e mbledhura. U realizua konsultim me këshilltarët e Komunës së Kërçovës, që të njoftoheshin me strategjinë rinore dhe çështjet që të rinjtë i konsideronin si më të rëndësishme për ta. Pastaj

u bënë konsultime të hapura me nxënësit e shkollave të mesme, gjatë të cilave ata kishin mundësi të shprehnin mendimin e tyre rreth problemeve me të cilat përballen si dhe të propozonin zgjidhje të përshtatshme që do të zbatohen në të ardhmen. Po ashtu u realizuan takime me të rinjtë e Komunës së Kërçovës si dhe me përfaqësues të institucioneve në nivel lokal që punojnë me të rinjtë ose trajtojnë çështjet dhe fushat me interes për të rinjtë. Këto takime synonin të ndihmonin përcaktimin e problemeve dhe sfidave të të rinjve, si dhe zgjidhjen e tyre.

Të gjitha këto institucione kanë kontribuar gjatë përgatitjes së kësaj strategjie duke dhënë vërejtje për të krijuar aktivitete sa më të mira të cilat do të zbatohen së bashku me Këshillin Rinor dhe do t'i ndihmojnë të rinjtë për përmirësimin e cilësisë së jetesës në nivel lokal.

Procesi i përgjithshëm për përgatitjen e strategjisë i përshkruar më lart u zhvillua në disa faza:

- Shqyrtimi i dokumenteve ekzistuese, studimeve dhe analizave të ndryshme për politikën rinore në vend.
- Përgatitja e pyetësorit për identifikimin e nevojave dhe problemeve të të rinjve në Komunën e Kërçovës.
- Identifikimi i palëve të interesit për procesin e konsultimit lidhur me strategjinë rinore.
- Analiza e të dhënave të grumbulluara nga pyetësi.
- Takimi i parë konsultativ me Këshillin Komunal të Kërçovës.
- Dy takime konsultative me nxënësit e shkollave të mesme.
- Takimi konsultativ me të rinjtë e Komunës së Kërçovës.
- Takimi konsultativ me përfaqësuesit e institucioneve në nivel lokal.
- Takimi i dytë konsultativ me Këshillin Komunal të Kërçovës.

Nëpërmjet shqyrtimit të të gjitha dokumenteve relevante në nivel nacional dhe lokal, si dhe shqyrtimit të gjendjes, infrastrukturës dhe mundësive që të rinjtë kanë në komunitet, strategjia përqipet të pasqyrojë gjendjen e të rinjve në Komunën e Kërçovës. Strategjia pasqyron qëndrimet dhe perceptimet e të rinjve për politikën rinore, por edhe sfidat e tyre në Komunën e Kërçovës.

Për përmbushjen e prioriteteve strategjike dhe përcaktimet e tërësishme në fushat që parasheh kjo strategji, Këshilli Rinor do të hartojë plane veprimi në të cilat do të përfshihen hollësisht të gjitha aktivitetet dhe aksionet.

TË RINJTË NË KOMUNËN E KËRÇOVËS

Mungon botërisht një përkufizim i pranuar gjerësisht për nocionin “të rinj” dhe kufirin e moshës për këtë kategori. Kufiri i moshës ndryshon nga vendi në vend, madje ai ka ndryshuar edhe ndër vite. Në vitin 2006 nëpërmjet programit “Rinia në veprim” Bashkimi Evropian përcaktoi kufirin e moshës prej 15-25 vjeç, por ky kufi zgjerohej ndër vite. Kështu që gjatë miratimit të strategjisë për të rinj në vitin 2009, kufiri i moshës u zhvendos dhe u rrit nga 13-30 vjeç.

Në vendin tonë nuk ka asnjë ligj që rregullon nocionin “të rinj”, mirëpo Strategjia nacionale për të rinj 2005-2015¹, afati i së cilës skadoi, për herë të parë përkufizon këtë nocion. Sipas këtij dokumenti, të rinjtë përkufizohen si “[...] kategori socio-etnike e popullsisë në moshë prej 15-24 vjeç [...], [...] çdo veprim serioz apo program për të rinj duhet t’i marrë parasysh edhe personat prej 24-30 vjeç [...]”. Mirëpo edhe kjo strategji skadoi dhe u përpilua një e re, Strategjia nacionale për të rinj 2016-2025², në të cilën u rrit shumë kufiri i moshës për të rinjtë. Kështu që nocioni “të rinj” iu referohet të gjithë personave të moshave mes 15-29 vjeç. Kjo kategori bart potencial të madh dhe është resursi kryesor për progresin shoqëror, por edhe kategori me ndjeshmëri të veçantë ndaj ndryshimeve socio-ekonomike të shoqërisë. Gjithashtu, këto përkufizime dhe përcaktimi i kufijve të moshës për nocionin “të rinj” takohen edhe në disa strategji rinore lokale.

Komuna e Kërçovës është një nga 81 komunat e vendit tonë. Ajo ndodhet në pjesën perëndimore të vendit. Sipas të dhënave të marra nga Enti Shtetëror i Statistike³, numri i përgjithshëm i banorëve të Komunës në vitin 2015 ishte 56.645 banorë. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë, 14.169 ishin të rinj të moshave 15-29 vjeç, pra 25% e popullsisë së përgjithshme të Komunës. Në Komunën e Kërçovës vërehet një rritje e konsiderueshme e numrit të të rinjve nga viti 2012 deri në vitin 2015. Kjo rritje e konsiderueshme e numrit të të rinjve (gati gjysma) ndodhi në vitin 2014, pasi në vitin


1 Strategjia nacionale për të rinj 2005 - 2015

2 Strategjia nacionale për të rinj 2016 - 2025

3 Mak Stat Baza, www.stat.gov.mk

2013 Komunës së Kërçovës iu bashkuan Komuna e Zajasit, Oslloresë, Vraneshticës dhe ajo e Drugovës⁴.


Popullsia sipas grup-moshave specifike, gjinisë, komunave dhe vitit, në 30.06.2016



Sipas statistikave të fundit, sot popullata më e madhe janë të rinjtë e moshës 20-24 vjeç me 4.965 persona, pastaj 4.102 persona janë të moshës 15-19 vjeç, 3.067 persona të moshës 25-27 vjeç dhe 2.035 të rinj të moshës 28-29 vjeç.


Numri i të rinjve meshkuj, në krahasim me numrin e femrave, është relativisht i barabartë.

Popullsia sipas grup-moshave specifike, gjinisë, komunave dhe vitit, në 30.06.2016



4 Popullsia sipas grup-moshave specifike, gjinisë, komunave dhe vitit, në 30.06.2016, www.stat.gov.mk

Popullsia sipas grup-moshave specifike, gjinisë, komunave dhe vitit, në 30.06.2016



Në pjesën vijuese të Strategjisë rinore të Komunës së Kërçovës gjendet analiza për secilën fushë ku do të fokusohet Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës për 3 vjetët e ardhshëm. Për çdo fushë është bërë analizë në bazë të dokumenteve ekzistuese që referojnë për gjendjen e të rinjve në nivel lokal dhe nga të dhënat statistikore nga analiza e pyetësorëve të realizuar me përgjigjet e të rinjve të Komunës së Kërçovës. Në fund të çdo fushe ka rekomandime, të cilat duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për Këshillin Rinor gjatë përgatitjes së planeve vjetore të veprimit. Në vazhdim ndodhet analiza për këto fusha: arsimi, standardi social, migrimi, shëndetësia dhe sjelljet devijuese të të rinjve, integrimi ndëretnik, informimi rinor, pjesëmarrja rinore, planifikimi urban, kultura dhe sporti.

FUSHA: ARSIMI

Arsimi është e drejtë themelore e njeriut. E drejta e arsimit është edhe e drejtë kushtetuese. Ajo u mundëson fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve aftësi gjykimimi të argumentuar për të zgjedhur dhe për ta përmirësuar jetën e tyre; arsimi thyen rrethin magjik të varfërisë dhe është element themelor i zhvillimit ekonomik dhe social⁵.

Sistemi arsimor në vend rregullohet me ligje të veçanta për secilin nivel (arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i lartë). Në vitet e fundit arsimi ka pësuar një sërë ndryshimesh dhe reformash duke synuar të arrijë standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Megjithatë, një vazhdimësi e shpejtë e reformave sot e bën të pamundur një vlerësim përkatës dhe objektiv, dhe identifikimin e nevojave në proceset arsimore.

Sa i takon procesit arsimor, Komuna e Kërçovës ka 34 shkolla fillore të themeluara sipas Ligjit të arsimit fillor. Në procesin arsimor të këtij niveli, në vitin shkollor 2015/2016 janë regjistruar gjithsej 3.695 nxënës që ndjekin mësim në gjuhën maqedonase, shqipe dhe turke.

Në territorin e Komunës së Kërçovës ka 2 shkolla të mesme komunale⁶: SHMK "Drita" dhe SHMK "Mirko Mileski". Numri i përgjithshëm i nxënësve të shkollave të mesme të përfshirë në të dyja këto shkolla në vitin shkollor 2014/2015 ishte 2.011 nxënës. Në të dyja shkollat e mesme ekzistojnë organizata gjimnaziste, përkatësisht bashkësi të shkollave të mesme që synojnë mbrojtjen e të drejtave të nxënësve në proceset arsimore.

Arsimi i mesëm është i rregulluar me Ligjin e arsimit të mesëm dhe Ligjin e arsimit profesional. Në këto ligje është parashikuar që arsimi i mesëm në shkollat e mesme publike të jetë i detyrueshëm dhe falas. Në to realizohen planprogramet mësimore për arsim të mesëm - gjimnaz dhe arsim profesional.

Një nga proceset më të rëndësishme në vendin tonë ishte decentralizimi dhe pavarësimi i plotë i komunave për të ushtruar punën e tyre. Arsimi (fillor dhe i mesëm) është një nga kategoritë më të rëndësishme që u përfshinë në procesin e decentralizimit. Ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur në arsim lidhen me transferimin e vartësisë së shkollave nga niveli qendror në vetëqeverisjen lokale,

5 Strategjia nacionale për të rinj 2016 -2025.

6 Për nevojat e kësaj strategjie rinore do të shqyrtohen gjendjet dhe sfidat në arsimin e mesëm dhe të lartë, në përputhje me përkufizimin dhe kufirin e moshës për të rinjtë.

shpërndarjen e fondeve dhe burimeve financiare, përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave si dhe organizimin e transportit. Edhe pse fituan autonomi më të madhe me procesin e decentralizimit, prapëseprapë u shfaqën probleme dhe sfida për komunat, mes tyre janë edhe këto: disa prej ndërtesave shkollore që u trashëguan ishin në gjendje shumë të keqe; mungojnë të dhënat kadastrale; mungojnë kapacitetet administrative për menaxhimin dhe planifikimin e mjeteve; mospërfshirja e komunave gjatë hartimit të përmbajtjeve për arsimin e mesëm si dhe mungesa e koordinimit me qeverinë qendrore etj.

Në Strategjinë nacionale për të rinj 2016-2025, ashtu si në atë të mëparshme, një pjesë të madhe të kësaj fushe zë arsimit joformal dhe përkushtimi për ta avancuar atë. Përveç kësaj, ka hulumtime për arsimin të ne që tregojnë se nxënësit që ndjekin arsimin joformal dallohen pozitivisht nga ata që marrin pjesë vetëm në arsimin formal. Pra duhet të zbatohet ai dhe të inkurajohet pjesëmarrja e nxënësve në proceset e arsimit joformal.

Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës mund të kontribuojë shumë në këtë fushë⁷. Arsimit joformal është një nga përparësitë e tij, prandaj edhe në pyetësorin e shpërndarë si temë më vetë u hulumtua kjo çështje. Përveç kësaj, në këtë fushë u hulumtua edhe nevoja e të rinjve për biblioteka dhe salla leximi të pajisura mirë, si dhe transporti shkollor.

Si nevojë më të madhe në fushën e arsimit në qytet të rinjtë theksojnë nevojën për më shumë biblioteka dhe salla leximi të furnizuara me shumë libra. Madje 90,3% e të anketuarve e shquajnë këtë si nevojën më të rëndësishme dhe e kanë veçuar për t'u zgjidhur në periudhën e ardhshme. Edhe pse përgjegjësia kryesore e komunave nuk është ruajtja e bibliotekave dhe sallave të leximit që gjenden jashtë shkollave, sidomos kur bëhet fjalë për sistemin arsimor, megjithatë sipas të dhënave, të rinjtë thonë se kjo është nevoja e tyre më e madhe. Më tej në fushën e arsimit joformal, të rinjtë e Komunës së Kërçovës konstatojnë se arsimit joformal (trajnimet, shkollat verore, seminarët) duhet të jetë më i përfaqësuar në Komunë. Kjo do të thotë se është e domosdoshme që organizatat qytetare që merren me çështjet rinore, të zbatojnë më shumë aktivitete me të cilat do t'i përfshijnë të rinjtë e interesuar për punën e tyre. Nëse kemi parasysh se të rinjtë e Komunës së Kërçovës me 73,6% janë përgjigjur se arsimit joformal i edukon të rinjtë për të drejtat e tyre, mund ta kuptojmë rëndësinë e arsimit joformal për këtë komunitet dhe për të rinjtë. 74,5% e të anketuarve kanë theksuar se format e arsimit joformal (trajnimet, shkollat verore, seminarët) që iu janë ofruar të rinjve deri tani, janë të përshtatshme për nevojat e tyre duke shfaqur interes për t'u angazhuar. Në fakt, përfaqësimi i arsimit joformal në nivel komunal veçohet si sfida për punën e Këshillit Rinor, sepse të anketuarit e kanë theksuar si tepër të rëndësishëm. Nëse merren

⁷ Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës përbëhet nga përfaqësues të organizatave rinore dhe formave të ndryshme të grupimit rinor.

parasysh edhe hulumtime tjera në këtë temë⁸, mund të themi se vetëqeverisja lokale duhet të tregojë një interes të veçantë për avancimin e arsimit joformal. Për ta nxitur avancimin e arsimit joformal, pushteti lokal duhet t'i shqyrtojë nevojat e të rinjve për këtë arsim dhe t'i mbështesë financiarisht. Këtyre të dhënave iu është kushtuar kujdes i veçantë gjatë përgatitjes së strategjisë rinore lokale dhe po ato do të ndikojnë mbi përgatitjen e planeve vjetore të veprimit, përmes të cilave do të zbatohet strategjia rinore.

Arsimi në Komunën e Kërçovës nuk përfshin vetëm zbatimin e procesit arsimor nëpër objekte, përkatësisht ligjëratat dhe arsimin joformal, por edhe ofrimin e kushteve të nevojshme për realizim e procesit arsimor. Prandaj në fokusin e hulumtimit në fushën e arsimit ishte edhe transporti që iu mundësohet nxënësve me Ligjin e arsimit të mesëm. 65,1% e të anketuarve thonë se të rinjtë nga vendet rurale kanë problem me transportin shkollor. Transporti i nxënësve në shkollë është plotësisht në juridiksionin e pushtetit lokal, prandaj të dhënat më lart janë shumë të rëndësishme për përgatitjen e dokumenteve/politikave të ardhshme. Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës duhet t'i përkushtohet përmirësimit të transportit për të rinjtë nga zonat rurale, që t'u lehtësohet aksesin në shkollat e mesme dhe të kenë kushte të barabarta si të rinjtë e zonave urbane.

Dhuna në shkollë është një temë me të cilën merren shumë shoqata qytetare dhe bashkësi ndërkombëtare për shkak të zhvillimeve të viteve të fundit dhe pranisë së tensioneve etnike, por edhe për shkak të shfaqjes së gjuhës së urrejtjes. Prandaj një pjesë e pyetësorit të përdorur iu dedikua kësaj teme si dhe formave të ndryshme të dhunës që mund të takohen në shkolla. Kjo është një nga temat së cilës Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës i kushton vëmendje të posaçme. Përqindja më e madhe e të anketuarve, pra 38,81% kanë deklaruar se në shkollë kanë vërejtur ngacmimin e qëllimshëm të ndonjë shoku/shoqeje dhe përdorimin e fjalëve fyese, 12,46% e të anketuarve kanë thënë se më së shpeshti kanë vënë re dhunë fizike, ndërsa 10,20% kanë vërejtur dëmtimin e sendeve apo objekteve që i përkasin shkollës. Këto të dhëna të marra nga të rinjtë në Komunën e Kërçovës janë identike me të dhënat e marra nga një studim i UNICEF-it mbi këtë temë⁹, i realizuar në nivel kombëtar. Këto gjendje na tregojnë se edukimi për parandalimin e dhunës është shumë i rëndësishëm. Nëse merret parasysh se të rinjtë arsimin joformal e shohin si mjet të domosdoshëm në procesin arsimor, bashkë me arsimin formal ai mund të kontribuojë për reduktimin dhe parandalimin e dhunës në shkolla dhe të shkatërrimit të inventarit shkollor.

8 Buova E., Dodovski I., "Arsimi joformal në Republikën e Maqedonisë: Gjendja dhe sfidat", MKC Manastir, 2009; mund ta lexoni në [http://mkcbt.org.mk/mkc/ep-content/uploads/2015/03/MKC BitolaNFOpublikacijaMK.pdf](http://mkcbt.org.mk/mkc/ep-content/uploads/2015/03/MKC%20BitolaNFOpublikacijaMK.pdf)

9 Qendra Algoritam, Enti i Zhvillimit të Arsimit, "Studim për gjendjen fillestare të dhunës në shkollat fillore në Maqedoni", viti 2009.

Këto të dhëna janë veçanërisht të rëndësishme dhe duhet të merren parasysh gjatë përgatitjes së aksioneve dhe aktiviteteve të ardhshme të Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës.

Të rinjve në Komunën e Kërçovës iu mundësohet vazhdimi i arsimit edhe në nivelin më të lartë. Në qytet ofrohen studime në: Fakultetin Tekniko-teknologjik në kuadër të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" nga Manastiri; studime juridike në Fakultetin Juridik - Kërçovë në kuadër të Universitetit "Shën Kliment Ohridski"-Manastir; studime të dispersuara të Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës; studime të dispersuara të Fakultetit Ekonomik, drejtimi Kontabilitet dhe Financa, të Universitetit Shtetëror të Tetovës; studime të dispersuara të Fakultetit Filologjik, drejtimi i Gjuhës Angleze, të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Në kuadër të arsimit të lartë në Komunën e Kërçovës ka edhe organizata studentore, përkatësisht parlamente studentore që shërbejnë si përfaqësues të studentëve në proceset e vendimmarrjes në arsimin e lartë. Karakteristike për arsimin e lartë, i cili është i rregulluar me Ligjin e arsimit të lartë, është që kjo shkallë e arsimit gëzon autonomi të posaçme dhe autoritetet lokale nuk kanë kompetenca dhe të drejtë të marrin pjesë në organizimin dhe zbatimin e tij. Prandaj edhe nuk kemi përfshirë pyetje hulumtuese për këtë tematikë e as kemi paraparë aktivitete. Megjithatë ka çështje (si psh.: organizimi, të informuarit e të rinjve) që në një formë të tërthortë e prekin këtë nivel të arsimit.

Gjatë përgatitjes së planeve të veprimit për zbatimin e strategjisë rinore, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës në vitet e ardhshme kujdes të posaçëm do t'u kushtojë çështjeve të cilat të rinjtë i veçojnë si sfiduese dhe për të cilat alarmojnë se duhet të zgjidhen.

Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës në periudhën e ardhshme do orvatet t'i rritë fondet e bibliotekave dhe të sallave të leximit me libra që të rinjve iu duhen gjatë arsimit formal, por edhe me literaturë interesante dhe profesionale e cila mund t'i ndihmojë gjatë mësimin. Gjithashtu, Këshilli Rinor do të përqendrohet në organizimin e një sërë evenimentesh (shkëmbimi i librave, biblioteka e rrugës), nëpërmjet të cilave do të bëjë një fond shumë më të madh dhe më të plotë librash që do të jenë në dispozicionin e të rinjve, duke përmbushur kështu nevojat e tyre.

Sa i takon arsimin joformal, duke bashkëpunuar me shoqatat qytetare, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës në periudhën e ardhshme do t'i inkurajojë ato ta promovojnë arsimin joformal dhe të organizojnë më shumë trajnime dhe seminare për të rinjtë e kësaj komune. Në fokus do të jenë trajnimet që trajtojnë tematikën e të drejtave qytetare të të rinjve, nxënësve dhe studentëve, duke ditur se kjo është mënyra më e zakonshme si të rinjtë arsimohen rreth këtyre temave. Përveç bashkëpunimit me shoqatat qytetare, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës në planprogramin e tij do të parashohë një sërë aktiviteteve mbi temën e arsimit joformal. Këtë planprogram

Këshilli Rinor do ta zbatojë për të përmbushur nevojat e të rinjve dhe për t'iu përgjigjur sfidave me të cilat përballen të rinjtë.

Gjatë përgatitjes së aktiviteteve për parandalimin e dhunës në shkolla, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do t'i ketë parasysh aktivitetet dhe udhëzimet që janë pjesë e Strategjisë për uljen e numrit të rasteve të dhunës në shkolla, për vitet 2012-2015¹⁰. Edhe pse i ka skaduar afati, kjo strategji përfshin aktivitete që duhet të vazhdojnë të zbatohen medoemos në të ardhmen. Gjithashtu, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të përfshihet në të gjitha aktivitetet për përgatitjen eventuale të një strategjie të re të këtij lloji. Gjatë përgatitjes së aktiviteteve për këtë çështje do të merren në konsideratë edhe të dhënat dhe aktivitetet e projektit "Së bashku për shkolla pa dhunë", i cili u dedikohet shkollave në faqen e internetit të së cilës mund të gjenden lajme dhe aktivitete nga shkollat, prindërit, mësimmshënësit dhe nxënësit¹¹. Përveç kësaj, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të kujdeset që përmes fushatave dhe edukimit adekuat të ullet gjuha e urrejtjes.

Gjatë përgatitjes së planeve të veprimit për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të kësaj strategjie, do të lihet hapësirë për çështje të reja dhe aktuale në fushën e arsimit me interes për të rinjtë.

Për zbatimin e aktiviteteve në këtë fushë, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të bashkëpunojë me shkollat e mesme të komunës, me institucionet e arsimit të lartë, me Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe me shoqatat qytetare në nivel lokal.

10 Strategjia për uljen e numrit të rasteve të dhunës në shkolla, 2012-2015, <http://arhiva.vlada.mk/registar/?q=node/411>

11 Së bashku për shkolla pa dhunë, www.beznasilstvo.mk



PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E ARSIMIT

- Rritja e frekuencës së transportit për nxënësit e shkollave të mesme nga pjesët rurale në pjesët urbane të Komunës së Kërçovës dhe anasjelltas;
- Mbështetje për arsimin joformal si dhe për shoqatat qytetare rinore në Komunën e Kërçovës;
- Mundësimi i një numri më të madh trajnimesh dhe akademish verore për të rinjtë e komunës;
- Promovimi dhe rritja e numrit të të rinjve që marrin pjesë në arsimin joformal në Komunën e Kërçovës;
- Rritja e fondit dhe numrit të bibliotekave dhe sallave të leximit në komunë;
- Rritja e vetëdijes së të rinjve për dhunën në shkolla dhe për parandalimin e saj.

FUSHA: STANDARDI SOCIAL


Standardi social është një temë e gjerë e cila përfshin shumë çështje për të rinjtë, duke filluar nga procesi i punësimit e deri te themelimi i shtëpisë vetjake. Kjo temë është veçanërisht e rëndësishme për ta, kur dihet se në shumë vende të botës të rinjtë gëzojnë shumë përfitime nga statusi i tyre në shoqëri. Për përfshirjen e tyre në këtë strategji, temat që u hulumtuan ishin punësimi dhe vetëpunësimi i të rinjve, dobitë që i gëzojnë në shoqëri si dhe strehimi i të rinjve dhe çifteve të reja bashkëshortore.

Punësimi është një hap shumë i rëndësishëm në jetën e çdo të riu, sidomos për vetërealizimin dhe transformimin e tij në një shoqëri. Shpeshherë punësimi është hapi i parë drejt arritjes së pavarësisë financiare dhe sociale [...] i lidhur ngushtë me cilësinë e jetës së të rinjve, vetëbesimin e tyre, mundësitë për lëvizje (mobilitet), por edhe me vendime praktike që lidhen me vendin e banimit, krijimin e familjes dhe me hartimin e rrugëtimit të ardhshëm në zhvillimin profesional dhe të karrierës¹². Megjithatë papunësia e të rinjve te ne është ende shumë e lartë dhe për përmirësimin e gjendjes nevojiten aktivitete, si nga pushteti qendror, ashtu edhe nga ai lokal. Më poshtë janë të dhënat për papunësinë e të rinjve në nivel shtetëror¹³.

¹² Strategjia nacionale për të rinj 2016-2025.

¹³ Shkalla e papunësisë sipas gjinisë, moshës dhe vitit, e popullsisë mbi 15 vjeç www.stat.gov.mk

Shkalla e papunësisë sipas gjinisë, moshës dhe vitit, e popullsisë mbi 15 vjeç



Sfida kryesore që ndikon në nivelin e papunësisë së të rinjve është situata e përgjithshme ekonomike në vend, e cila në radhë të parë vjen nga mungesa e ofertave përkatëse për vende pune, si nga numri, ashtu edhe nga cilësia. Shpeshherë punëdhënësit theksojnë se të rinjtë nuk kanë kompetenca përkatëse që i kërkon tregu i punës. Sipas Planit të veprimit për punësimin e të rinjve për vitin 2015, pavarësisht nga ngritja e nivelit të arsimit, shumica e të rinjve në vend përballen me problemin për t'u integruar në tregun e punës dhe me pamundësinë për t'u punësuar menjëherë pas mbarimit të shkollimit, kryesisht nga mospërputhja e arsimit me kërkesat e tregut të punës¹⁴. Në hulumtimin e Bankës Botërore "Kërkesa për shkathtësi në IRJ të Maqedonisë" të realizuar në rreth 1.700 kompani, punëdhënësit vendorë theksojnë se si për të qenë pjesë e tregut të punës, të rinjve u mungojnë shkathtësitë siç janë përgjegjësia, motivimi, komunikimi, kujdesi për klientin, puna në ekip pavarësisht dijeve specifike lidhur me tematikën e punës¹⁵. Në Strategjinë nacionale të punësimit të vitit 2015¹⁶ dhe në Planin e veprimit që është dokument shoqëruës, theksohet angazhimi i qeverisë për ta trajtuar gjendjen e punësimit të të rinjve mu për shkak të ndjeshmërisë së tyre si kategori shoqërore dhe të qenit të ekspozuar ndaj përjashtimit shoqëror. Sfidat kryesore të identifikuara janë: (1) rritja e zhvillimit ekonomik dhe rritja e normës së investimeve, që të rritet numri i vendeve të reja të punës; (2) përmirësimi i nivelit të përgjithshëm të punësimit, sidomos i punësimit të të rinjve, të të papunëve afatgjatë

14 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Plani aksionar për punësimin e të rinjve i vitit 2015; mund ta lexoni në www.mtsp.gov.mk/content/pdf/vrabetuvanje_mladi_akciski.pdf

15 Rutkowski J., "Demand for skills in FYR Macedonia", 2010.

16 Strategjia nacionale për punësim e vitit 2015; mund ta lexoni në <http://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nspix>

dhe të individëve me nivel arsimor të ulët; (3) përmirësimi i rëndësisë së sistemit të arsimit dhe trajnimit për tregun e punës; dhe (4) ulja e punësimit joformal. Përballja me këto sfida kërkon politika të harmonizuara në fushën e investimeve, të promovimit të ndërmarrjeve, edukimit dhe trajnimit, dialogut shoqëror dhe politikave aktive në tregun e punës.

Viteve të fundit në vendin tonë u zbatuan masa që subvencionuan punësimin e të rinjve, si dhe u realizuan projekte së bashku me UNDP-në që subvencionuan vetëpunësimin e të rinjve. Pikërisht ekzistimi i këtyre masave ishte temë hulumtimi e pyetësorit tonë në pjesën për hulumtimin e standardit social në Komunën e Kërçovës. Këto masa përfshinin një sërë aktiviteteve për promovimin e shkathtësive të punës së të rinjve, si të gjenin punë sa më lehtë si dhe t'i u përgjigjeshin sfidave të punës. Në fakt, shkathtësitë e punës dhe mungesa e trajnimeve që rritin shkathtësitë për punë të të rinjve janë prioriteti më sfidues për Këshillin Rinor të Komunës së Kërçovës; këtë e kanë veçuar 85,8% e të rinjve të anketuar. Më tej, 50,7% e të rinjve nuk janë të informuar për njoftimet, përkatësisht për ofertat e punës së të rinjve, si dhe për masat për vetëpunësim. Kjo është mundësi që Këshilli Rinor së bashku me Komunën e Kërçovës dhe Agjencinë e Punësimit në periudhën e ardhshme të përqendrohen për shpërndarjen e informatave lidhur me punësimin e të rinjve, që të rritet punësimi dhe shkathtësitë e nevojshme për punësim për të rinjtë e kësaj komune. Me përmirësimin e kësaj çështjeje do të rritet edhe standardi social.

Mundësia e pasjes së banesës vetjake është pjesë e ciklit jetësor të të rinjve dhe kjo varet drejtpërdrejt nga punësimi i tyre dhe standardi që kanë. Vitet e fundit pushteti qendror miratoi edhe masa për lehtësimin e themelimit të banesës/shtëpisë për të rinjtë dhe çiftet e reja bashkëshortore¹⁷. Këto mundësi janë shumë të rëndësishme në qoftë se merren parasysh të dhënat e hulumtimeve ku gati 80% e të rinjve mbi 18 vjeç jetojnë ende me prindërit e tyre, ndërsa 14,5% jetojnë me një partner dhe vetëm 3,2% jetojnë vetë. Arsyet janë praktike ose nuk ka arsye të veçanta pse të rinjtë jetojnë ende me prindërit e tyre; fjala vjen: 35% e të rinjve thanë se jetojnë me prindërit e tyre për arsye praktike, ndërsa një numër po aq i madh nuk kanë treguar ndonjë arsye të veçantë se pse jetojnë me prindërit¹⁸. Për këto arsye u hulumtuan këto pyetje, që të përgatitet strategji rinore përkatëse për nivelin e Komunës së Kërçovës. Banesën dhe pasjen e një banese personale të rinjtë e anketuar e përcaktuan si një problem të madh sa i përket standardit social. 82,4% e të anketuarve thonë se të rinjtë e kanë të vështirë të blejnë banesë personale dhe të jetojnë të ndarë nga familja. Pamundësinë për të pasur banesë personale të anketuarit e përcaktojnë si problem edhe për çiftet e reja bashkëshortore. Kështu, 78,19% e të anketuarve thonë se çiftet e reja e kanë shumë

17 Projekti "Blej shtëpi, blej banesë" www.kupikukakupistan.gov.mk

18 Topuzovska-Latković M., dhe t.j., "Studim për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë", Fondacioni Fridrih Ebert 2013; mund ta lexoni në www.fes.org.mk/pdf/pub-mk-13.pdf

të vështirë të fitojnë banesë personale, ndërsa 68,8% e të anketuarve thonë se çiftet e reja nuk janë të informuar për masat dhe subvencionet ekzistuese që mundësojnë banim vetjak. Banimi i të rinjve dhe mundësia për banesë më vete trajtohen si probleme dhe sfida serioze nga Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës.

Si pjesë e standardit social të të rinjve janë edhe masat dhe dobitë që i gëzojnë në shoqëri. Këtu bëjnë pjesë edhe dobitë për nxënësit dhe studentët që jep procesi arsimor, por edhe masat specifike që synojnë jetë sa më cilësore për të rinjtë në shoqëri. Në këtë mënyrë del se beneficion është edhe transporti publik falas për të rinjtë, si dhe beneficionet rinore për evenimentet kulturore etj. Sa u takon pyetjeve për beneficionet sociale që i gëzojnë të rinjtë dhe që u përfshinë në pyetësin tonë, rreth 75% u përgjigjën se të rinjtë nuk kanë beneficione të tilla. Mosekzistimi, por edhe pamjaftueshmëria e beneficioneve sociale ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së të rinjve por edhe në pjesëmarrjen aktive në shoqëri.

Për parashikimin dhe zbatimin e aktiviteteve për këtë fushë të strategjisë, Këshilli Rinor do të ballafaqohet me sfida të mëdha, në radhë të parë duke pasur parasysh se tema e punësimit të të rinjve është një nga sfidat më të rëndësishme dhe më serioze me të cilat përballet i tërë vendi. Megjithatë, promovimi përkatës i masave që nxisin punësimin dhe vetëpunësimin, dhe afrimi i këtyre informatave të të rinjtë do të jetë një nga detyrat e Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës në periudhën e ardhshme. Veç kësaj, rritja dhe avancimi i shkathhtësive të të rinjve që të jenë në gjendje të përballen me sfidat në vendet e tyre të punës është gjithashtu një nga detyrat e Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës. Duke bashkëpunuar në mënyrë përkatëse me institucionet përgjegjëse, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të përpiqet të arrijë qëllimet maksimale në këtë fushë.

Prezantimi adekuat, informimi dhe shfrytëzimi i masave për përfitim të banesës nga të rinjtë do të zërë një vend të posaçëm në aktivitetet dhe punën e Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës. Këtë do ta bëjë duke ofruar ndihmë dhe shërbime këshilldhënëse për shfrytëzimin e masave për blerjen e banesës ose shtëpisë për të rinjtë në Komunën e Kërçovës.

Sa u takon dobive që shfrytëzojnë të rinjtë, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të punojë për ta avancuar gjendjen aktuale dhe zbatimin e shumë masave në të cilat do të përfshihen edhe çështje kulturore të rinisë, të cilat ndikojnë në standardin social të të rinjve, për shfrytëzimin maksimal të masave ekzistuese dhe nxitjen e dobive të reja që të përmirësohet cilësia e jetës së të rinjve.

Si në çdo fushë tjetër, edhe këtu do të ketë hapësirë për përfshirjen e aktiviteteve për tema aktuale dhe sfida me të cilat ballafaqohen të rinjtë në nivel lokal. Për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve në këtë fushë, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të bashkëpunojë me Agjencinë e Punësimit, institucionet përkatëse të pushtetit qendror dhe institucionet kulturore lokale, shoqatat qytetare dhe të rinjtë. Për këtë fushë dhe

për të përmirësuar shkathhtësitë e të rinjve, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të bashkëpunojë edhe me institucionet arsimore në të gjitha nivelet.



PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E STANDARDIT SOCIAL


- Informimi dhe mbështetja e të rinjve për mundësitë e punësimit dhe vetëpunësimit të tyre;
- Mbështetja dhe zhvillimi i vullnetarizmit në komunitetin lokal;
- Informimi dhe mbështetja e të rinjve për shfrytëzimin e mundësive për blerjen e banesës/shtëpisë për të rinjtë dhe çiftet e reja bashkëshortore në Komunën e Kërçovës;
- Mundësimi i dobive sociale për të rinjtë, për ta avancuar cilësinë e jetës së tyre në Komunën e Kërçovës;
- Nxitja e bashkëpunimit me institucionet përkatëse për tejkalimin e problemeve me të cilat ballafaqohen të rinjtë dhe për avancimin e pozitës së të rinjve.

FUSHA: MIGRIMI

Migrimi paraqet një fushë për të cilën rrallë flitet në shtetin tonë, por e cila është shumë alarmante. Migrimet mund të shkaktojnë rrjedha të ndryshme të ekonomisë, e si pasojë e kësaj të ndikojnë edhe në standardet e një shoqërie, si dhe të cilësisë së jetesës për të rinjtë në rajone të caktuara. Në fakt, kjo fushë është edhe fusha më alarmante për të cilën më së shumti shqetësohen të rinjtë e komunës së Kërçovës, sipas përgjigjeve të tyre të dhëna në pyetësor.


Sipas të dhënave zyrtare nga Enti Shtetëror për Statistikë, numri i të rinjve të shpërngulur nga komuna e Kërçovës është në rritje në vitet e fundit. Kjo rritje e numrit mund të jetë shkaktuar edhe nga bashkëngjitja e 4 komunave të tjera me atë të komunës së Kërçovës, për të cilën çështje u bë fjalë më herët në fushën e arsimit. Sipas këtyre të dhënave, në këtë statistikë hyjnë vetëm ata të rinj që zyrtarisht (me ndërrimin e adresës) janë shpërngulur nga komuna. Këtu nuk janë përfshirë të dhënat për të rinjtë që shkojnë në qytete të tjera për të studiuar.

Migrimet e brendshme: qytetarë të shpërngulur sipas moshës, komunave dhe vitit




Nga këto të dhëna të marra nga faqja zyrtare e Entit Shtetëror të Statistikave, mund të shihni se më shumë është shpërngulur popullata e re e gjinisë femërore, në krahasim me atë mashkullore.

Migrimet e brendshme: qytetarë të shpërngulur sipas gjinisë, moshës, komunave dhe vitit



Migrimet e brendshme: qytetarë të shpërngulur sipas gjinisë, moshës, komunave dhe vitit



Pikërisht për shkak të këtyre të dhënave dhe tendencës së migrimit të të rinjve të vendit tonë, kjo temë kishte vend të posaçëm në pyetësor. Në të përfshimë pyetje për migrimin e të rinjve për punë ose studime, kthimin e tyre në komunitet, etj. Ky seksion i pyetësorit dhe pyetjet e tij i ndamë në dy pjesë, përkatësisht në migrimin që ndodh për shkak të shpërnguljes jashtë komunës (shpërngulje në një qytet tjetër ose shtet tjetër), dhe migrimin që ndodh brenda komunës (shpërngulja nga fshati në qytet dhe anasjelltas). Duhet të theksohet se migrimi dhe çështjet e migrimit qenë shqetësimi që shënoi përqindjen më të lartë dhe u veçua si problemi më i madh i Komunës së Kërçovës. Për Këshillin Rinor të Komunës së Kërçovës do të jetë shumë e rëndësishme që në periudhën e ardhshme t'i përkushtohet punës dhe edukimit për

këtë problem kaq sfidues. Në pyetësorin tonë, 93,7% e të intervistuarve janë përgjigjur se migrimi i të rinjve të Komunës së Kërçovës ndodh ngaqë gjejnë punë në shtete të tjera. Përqindja e lartë për këtë çështje specifike tregon se shkaku kryesor i migrimit të të rinjve është punësimi, por në një shtet tjetër. Të anketuarit gjithashtu treguan se të rinjtë nga komuna largohen edhe për të studiuar. Kështu, 91,7% e të anketuarve thanë se migrimi ndodh edhe kur regjistrohen në arsimin e lartë. Kjo e dhënë duhet të merret në korrelacion edhe me praninë e institucioneve të arsimit të lartë në Komunën e Kërçovës, sidomos gjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve të Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës. Lidhur me këtë, rreth 87,2%, e të anketuarve shprehën shqetësimin se të rinjtë po largohen nga komuna për të gjetur punë në një qytet tjetër. Nga këto përgjigje dhe përqindja shumë e lartë mund të konstatohet se të rinjtë janë veçanërisht të shqetësuar për këtë problem. Të anketuarit gjithashtu si problem e përcaktojnë edhe çështjen e të rinjve që largohen për të studiuar ose për të punuar dhe rrallë kthehen për ta vazhduar jetën në komunën e tyre. Si problem serioz këtë e përcaktojnë madje 83,29% e të anketuarve.

Pjesa e dytë e pyetjeve në këtë seksion i referohet migrimit të të rinjve brenda komunës, si dhe nevojave të të rinjve që dalin si shkaku i migrimit të mundshëm. Kështu, një nga sfidat e të rinjve për të cilën mund të angazhohet Këshilli Rinor, është përmirësimi i mundësive (kultura, sporti, argëtimi, arsimimi) për të rinjtë që jetojnë në vendet rurale si dhe përmirësimi i transportit të rregullt për të rinjtë nga vendet rurale drejt pjesës urbane të komunës. Mundësimi i kushteve të tilla do të përmirësonte cilësinë e jetesës, por do të ndikonte edhe mbi migrimin si sfidë për t'u zgjidhur në periudhën e ardhshme në Komunën e Kërçovës.

Në vitet e ardhshme Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës duhet të fokusohet veçanërisht në këtë temë dhe për plotësimin e nevojave të të rinjve, si dhe për edukimin e të rinjve në këtë fushë. Në përputhje me mundësitë dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale të kësaj fushë, e rrjedhimisht edhe me kompetencat që mund t'i ketë Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës, aktivitetet që lidhen me këtë çështje do të ndihmojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës së të rinjve në zonat rurale, por edhe të rinjve në zonat urbane, si një nga mënyrat me të cilën mund të ulët migrimi në këtë komunë. Duke rritur cilësinë e arsimit, standardeve sociale si dhe mundësitë që kanë të rinjtë, Këshilli Rinor bashkë me të rinjtë e kësaj komune përmes një sërë aktiviteteve mund të alarmojë për sfidën dhe problemin me të cilën përballet Komuna e Kërçovës sa i përket migrimit. Është veçanërisht e rëndësishme të merren parasysh të dhënat si të rinjtë e perceptojnë "kthimin e të rinjve pas studimeve", ngaqë këto kthime janë të lidhura ngushtë me punësimin dhe cilësinë e jetesës që u mundësohet pas mbarimit të shkollimit. Këtu gjithashtu duhet shqyrtuar mundësia që Këshilli Rinor të përkushtohet t'i identifikojë nevojat për arsim të lartë të të rinjve dhe shkaqet pse largohen në qytete të tjera. Këtu lind pyetja nëse kjo vjen nga nevojë për arsim më të larmishëm

në krahasim me atë që ofrohet në nivel lokal apo ngaqë kërkojnë arsim më cilësor në fakultete dhe universitete të ranguara më mirë.

Këto të dhëna dhe fokusimi i Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës në këtë temë në periudhën e ardhshme mund ta përmirësojnë gjendjen e të rinjve dhe të ofrojnë informata me të cilat kjo çështje do të adresohet në mënyre strategjike në mënyrë që migrimi i të rinjve nga Komuna e Kërçovës të ulët.



REKOMANDIME STRATEGJIKE NË FUSHËN E MIGRIMIT

- Avancimi i pozitës së të rinjve në komunë;
- Identifikimi i nevojave të të rinjve dhe zbatimi i masave përkatëse për parandalimin e migrimit të të rinjve të komunës;
- Rritja e mundësive për të rinjtë për të përmirësuar cilësinë e jetës.

FUSHA: SHËNDETËSIA DHE PARANDALIMI

Shëndeti është gjendja e mirëqenies së plotë fizike, psikike dhe sociale, dhe jo vetëm mungesë e sëmundjeve ose të metave fizike¹⁹. Nisur nga ky përkufizim i gjerë, kjo fushë përfshin tema të ndryshme, si p.sh.: institucionet shëndetësore përkatëse, edukatën seksuale, veset e ndryshme të të rinjve, sigurinë e komunikacionit, ndjesinë e sigurisë në komunitet etj. Qëllimi i aktiviteteve dhe i pyetjeve në këtë fushë është identifikimi i nevojave përkatëse të të rinjve që më vonë të ndërmerren aktivitete të fokusuara në programet e parandalimit, shkëmbimin e informatave, edukimin e të rinjve, promovimin e stilit të shëndetshëm të jetesës etj.

Shëndeti i mirë në adoleshencë është shumë i rëndësishëm për mirëqenien dhe bazë për shëndetin e mirë më vonë gjatë jetës. Megjithatë, ne nuk investojmë sa duhet në çështje që kanë të bëjnë me parandalimin dhe ndërhyrjen e hershme të rinjtë e moshave 15-29 vjeç, prandaj kur shfaqen problemet, kjo kategori përballet me pengesa gjatë marrjes së kujdesit të duhur. Ka edhe tendenca inkurajuese, siç është zvogëlimi i numrit të duhanpirësve dhe aktiviteteve lidhur me HIV-in/AIDS-in, por në shëndetësi ka edhe çështje jokonsistente. Në vendin tonë flitet pak për disa çështje dhe punohet akoma më pak. Këtu i përfshijmë problemet e ndërlidhura me shëndetin mendor (përfshirë ankthin dhe vetëlëndimin), keqpërdorimin e substancave, mënyrën e të ushqyerit si dhe inkurajimin për relacion të shëndetshëm me mediat sociale. Sa u takon shërbimeve, ngelet nevoja për më shumë mbështetje miqësore/mes moshatarësh, më shumë trajnime për zhvillimin e adoleshentëve dhe më shumë të kuptuar të rregullave rreth besimit (konfidencës)²⁰.

Fatkeqësisht, në statistikat tona zyrtare nuk ka të dhëna shëndetësore kurse ato përmbledhen rrallë sipas moshës. Prandaj është shumë e vështirë të jepet një pasqyrë objektive për gjendjen shëndetësore të të rinjve, sidomos për ata që për një ose tjetër arsye janë të marginalizuar.

Megjithatë, sipas hulumtimeve të bëra nga palë të ndryshme të shoqërisë tonë, shëndeti dhe çështja e parandalimit të rinjtë është e mirë. Kështu, shëndeti i

19 Përkufizimi sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë

20 Analiza e Strategjisë nacionale për të rinjtë 2016-2025, www.strategjiazamladi.mk

përgjithshëm i të rinjve të moshës prej 15 deri 29 vjeç është në nivelin e kënaqshëm (85% e të anketuarve kanë deklaruar që gjendja e tyre shëndetësore është “e shkëlqyeshme” ose “shumë e mirë”). Bazuar në të dhënat që rrjedhin nga shkalla e shëndetit mendor e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të rinjtë shfaqin harmoni emocionale solide mes aktiviteteve jetësore dhe përpjekjeve për të arritur stabilitet psikik (92% kanë manifestuar “shëndet mendor mesatar” ose “shëndet mendor të shkëlqyer”)²¹. Megjithatë, edhe pse të rinjtë konsiderojnë se janë në gjendje shëndetësore të mirë, kjo fushë ka shumë sfida me të cilat ata duhet të përballen.

Sa i takon sistemit shëndetësor dhe të drejtave që dalin nga sistemi shëndetësor i vendit tonë, të rinjtë e Komunës së Kërçovës kanë pak njohuri dhe nuk janë të kënaqur me cilësinë e tij. 71,1% thonë që nuk janë të kënaqur me cilësinë e mbrojtjes shëndetësore që marrin kur kanë nevojë. Që të arrijnë kënaqësinë maksimale dhe qëndrueshmëri të shërbimeve shëndetësore që u ofrohen të rinjve, ato duhet të krijohen në përputhje me nevojat e tyre, kurse në raste të caktuara edhe të dallohen nga ato që iu jepen të rriturve. Gjithashtu të rinjtë duhet të udhëzohen të informohen drejt për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve, si dhe për marrjen e mbështetjes psikologjike dhe sociale. Rinia është një periudhë e eksperimenteve dhe ndryshimeve të mëdha të cilat i kalon çdo person. Shprehitë shëndetësore dhe sjellja e krijuar dhe e mësuar në këtë periudhë barten gjatë gjithë jetës dhe ndikojnë në moshën e rritur. Këto shprehë përfshijnë mënyrën e ushqimit, pirjen e duhanit, pirjen e alkoolit, përdorimin e drogës dhe substancave tjera psikoaktive, raporti ndaj aktivitetit fizik dhe shprehitë seksuale²². Një mënyrë për të qenë sa më të kënaqur me mbrojtjen shëndetësore në një vend është informimi i mirë i të rinjve për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që dalin prej saj. Vitet e fundit në vendin tonë janë futur disa masa sociale që e përfshijnë ose e cenojnë të drejtën e mbrojtjes shëndetësore, veçanërisht për të rinjtë. Prandaj i hulumtuam njohuritë e të rinjve për mbrojtjen shëndetësore dhe ekzistimin e dobive të reja. Ajo që është veçanërisht shqetësuese e për të cilën Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës mund të kontribuojë për ta përmirësuar, është mosinformimi i të rinjve për të drejtën e mbrojtjes shëndetësore. 75,9% e tyre janë përgjigjur se nuk janë në dijeni se mund ta humbasin mbrojtjen shëndetësore falas. Për këtë çështje është i nevojshëm edukimi i të rinjve që t'i ushtrojnë dhe t'i mbrojnë të drejtat e tyre.

Në konsultimet e bëra me këshilltarët në Komunën e Kërçovës si dhe me përfaqësuesit e institucioneve shëndetësore përkatëse në këtë fushë, u shfaq shqetësimi për dukuritë devijuese, në veçanti përdorimi i alkoolit dhe substancave psikotrope nga të miturit. Në përputhje me deklaratat e palëve kompetente, Këshilli Rinor i Komunës

21 Instituti i Hulumtimeve Sociologjike dhe Politiko- juridike, “Raporti për gjendjen e të rinjve”, dhjetor 2014.

22 Plani aksionar për implementimin e Strategjisë nacionale për të rinj 2009.

së Kërçovës, në bashkëpunim me këto institucione, në periudhën e ardhshme duhet të realizojë aktivitete për rritjen e vetëdijes së të rinjve për veprimet e dëmshme të këtyre dy dukurive.

Në fushën e shëndetësisë dhe sjelljeve devijuese të të rinjve, për nevojat e strategjisë rinore u hulumtua sa janë të kënaqur të rinjtë me jetën që jetojnë, me mundësitë e mbrojtjes shëndetësore, sjelljet devijuese, sigurinë në shoqërinë e tyre dhe sigurinë në shkolla. Rezultatet u mblodhën nga përpunimi i pyetjeve të ndryshme për sigurinë dhe besueshmërinë që kanë (janë renditur më shumë vende siç janë: lagjja, shkolla, stacionet e autobusëve, vendet ku kalojnë kohën e tyre të lirë etj.). Nga përgjigjet e tyre mund të përfundojmë se kur lëvizin në shoqërinë që njohin (shkollë, qendër, lagje, stacioni i afërt i autobusit), të rinjtë ndihen të sigurt. Megjithatë, më të sigurt ndihen në lagjen e tyre (81,3%). Të dhënat e tilla për të rinjtë e Komunës së Kërçovës përputhen me të dhënat në nivel shtetëror, ku gati 90% e të rinjve të përfshirë në hulumtim janë përgjigjur se ndihen të sigurt aty ku jetojnë; nuk ka dallim në mes të rinjve nisur nga përkatësia etnike, gjinia, moshja, vendbanimi ose rajoni²³. Sipas të dhënave të grumbulluara nga pyetësi për strategjinë rinore, vend tjetër ku ndihen më të sigurtë është qendra e komunës (77,3%). Stacionet e autobusëve janë vlerësuar si vende ku poashtu ndihen të sigurtë (71,6%), si dhe shkollat (69,1%). Duke u nisur nga përgjigjet, mund të konstatohet se mendimi i përgjithshëm i të rinjve është se Komuna e Kërçovës është një komunë e sigurt. Megjithatë në këtë pyetësor të rinjtë shquajnë disa çështje që lidhen me ndjenjën e sigurisë, me theks të veçantë te siguria e komunikacionit. Niveli i sigurisë në mesin e të rinjve zvogëlohet kur është fjala për komunikacionin. 66,5% u përgjigjën se lëvizja e tyre në komunë si këmbësorë është vështirësuar, ndërkohë që 77,6% e tyre u përgjigjën se drejtimi i automobilin në komunë vështirësohet nga kultura e ulët e komunikacionit. Sipas të dhënave dhe publikimeve të Këshillit Republikan të Sigurisë së Komunikacionit, të rinjtë janë kategoria që e respekton më pak kufirin e shpejtësisë së lëvizjes. Kur flasim për pjesëmarrjen në aksidente rrugore, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç priren të përfshihen shpesh në aksidente rrugore. Rreziku mund të shqyrtohet nga shumë aspekte; e para nga mospërvoja, pastaj tendenca për sjellje të rrezikshme, dhe e treta nga gabimet fillestare që bëjnë shoferët e rinj. Përgjithësisht vozitësit e rinj në vitet e para nuk janë të vetëdijshëm me cilat rreziqe do të ballafaqohen në komunikacion²⁴.

Duke u nisur nga këto të dhëna dhe nga siguria e zvogëluar mes të rinjve, Këshilli Republikan i Sigurisë në Komunikacion në programet e tij ka aktivitete që iu dedikohen

23 Topuzovska-Latkoviq M., e tj., "Studimi për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë", Fondacioni Fridrih Ebert 2013; mund ta lexoni në www.fes.org.mk/pdf/pub-mk-13.pdf

24 Tribuna "Të rinjtë dhe siguria në komunikacion", Kumanovë; më shumë informata në <http://www.rsbsp.org.mk/rsbsp-na-tribina-na-tema-mladite-i-bezbednosta-vo-soobrakajot-vo-kumanovo>

të rinjve dhe sigurisë së komunikacionit, me fokus të veçantë mbi të rinjtë që drejtojnë automobila dhe motoçikleta, si dhe mbi këmbësorët²⁵.

Në përputhje me përfundimet e lartpërmendura, të rinjtë duhet të edukohen për të drejtat që iu ofron mbrojtja shëndetësore. Edukimi i tillë duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe t'i ngërthejë të gjitha problemet dhe sfidat me të cilat mund të përballen një njeri i ri (veset, edukimi seksual, të drejtat dhe detyrimet në shëndetësi, nxënësit dhe mbrojtja shëndetësore etj.). Prandaj një nga aktivitetet e Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës do të jetë ndërlidhja e kategorive të ndryshme të të rinjve me temat përkatëse nga mbrojtja shëndetësore. Në këtë mënyrë do të inkurajohet përdorimi i të drejtave dhe mundësive që u ofrohen në vendin tonë.

Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do t'i ndjekë rregullisht statistikën dhe problemet e shëndetit të të rinjve, por edhe çështjet e parandalimit, që të mund t'i trajtojë, si çështjet ashtu dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë në nivel lokal, ndonëse ato nuk janë pjesë e këtij dokumenti strategjik.

Që të rritet siguria e të rinjve në komunikacion, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të fokusohet tek edukimi i të rinjve përmes punëtorëve, aksioneve dhe aktiviteteve që do të rritin vetëdijen e tyre, por edhe të popullatës më të gjerë. Aktivitetet e tilla Këshilli Rinor do t'i zbatojë së bashku me institucionet përkatëse të kësaj fushe, ashtu që të rinjtë të jenë më të kënaqur dhe më të informuar me mbrojtjen shëndetësore, dhe t'iu rritet ndjenja e sigurisë në komunën e tyre.

²⁵ Raporti vjetor për aktivitetet e realizuara nga Këshilli Republikan i Sigurisë së Komunikacionit Rugor 2015, www.rsbsp.org.mk



PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË DHE PARANDALIMIT

- Informimi i të rinjve për të drejtat dhe obligimet që dalin nga sigurimi shëndetësor;
- Promovimi i edukimit të të rinjve për shprehi të shëndetshme jete;
- Parandalimi dhe edukimi i të rinjve për ndikimin e dëmshëm të të gjitha vartësive;
- Rritja e vetëdijes dhe edukimi i të rinjve për kulturën e komunikacionit;
- Rritja e vetëdijes në komunitet për sigurinë e komunikacionit.

FUSHA: INTEGRIMI NDËRETNIK

Në shoqërinë tonë integrimi ndëretnik është shumë i rëndësishëm dhe i përcaktuar me aktin më të lartë juridik të vendit. Kështu, në nenin 8, alineja 2, të amendamentit VI të Kushtetutës parashihet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të të gjitha bashkësive në të gjitha nivelet e organeve të pushtetit dhe institucionet e tjera publike²⁶. Përveç Kushtetutës, edhe disa ligje të tjera pasqyrojnë realitetin multi-etnik (Ligji i arsimit fillor, Ligji i arsimit të mesëm, Ligji i pushtetit lokal etj.). Përkundër të gjitha masave që shteti zbatoi për ta përmirësuar integrimin ndëretnik, duhet të theksohet se vetëm një numër i vogël i tyre lidhen me të rinjtë. Kur flitet për të rinjtë dhe integrimin ndëretnik, fokusi kryesor vihet tek integrimi ndëretnik në arsim, duke menduar se kështu synimi mund të realizohet më së miri. Në fakt, përmes procesit arsimor duhet të promovohet multikulturalizmi duke kontribuar për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në vend. Multikulturalizmi dhe adresimi i marrëdhënieve ndëretnike në arsim janë bazë e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe e ndërtimit të një shoqërie të bashkuar (kohezive). Edhe pse aspiratat për t'u anëtarësuar në BE/NATO janë të përbashkëta për të gjithë qytetarët e vendit, prapë shtrohet pyetja sa janë të gatshëm nxënësit të jetojnë në familjen multikulturore dhe multi-etnike të Bashkimit Evropian. Në këtë vend nxënësit së pari duhet të mësojnë t'i kuptojnë, t'i pranojnë dhe t'i respektojnë dallimet në vendin e tyre, që të integrohen fillimisht në shoqërinë e tyre, e më pas mund të aspirojnë integrimin e plotë në familjen evropiane²⁷.

Ajo çfarë ndodh në jetën e përditshme është rritja e ndarjeve në arsim. Në deklaratën e tij të dhënë në mbledhjen plenare të 718-të të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare, thotë se "ka një trend alarmant ndarjeje në baza etnike"²⁸. Sipas tij, kjo ndarje në disa raste sjell edhe dhunë. Komisioneri i ka dorëzuar ministrit të Arsimit rekomandime specifike për integrimin

26 Kushtetuta <http://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nsp>

27 Violeta Petroska-Beshka, Mirjana Najcevska, Nikola Kenig, Safet Balazhi dhe Ana Tomovska, "Studim për multikulturalizmin dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim", 2009.

28 Statement by Knut Vollebaek, OSCE High Commissioner on National Minorities, The 718th plenary meeting of the OSCE Permanent Council (2009).

përmes arsimit²⁹. Në raport theksohet se arsimi i ndarë kushton shumë shtrenjt kur përpqemi të ndërtojmë shoqëri të bashkuar dhe se arsimi i integruar nuk ndërtohet vetëm nga sjellja e fëmijëve nga grupe të ndryshme etnike në një klasë, por përfshin: menaxhim demokratik dhe të decentralizuar me shkollat, tekste shkollore interesante dhe përfshirëse, aktivitete jashtëmësimore si dhe për programe dhe tekste shkollore të depolitizuara. Sipas Komisionerit, në këtë fushë vendi ka ngelur prapa, prandaj toleranca ndëretnike duhet të vihet sërish në rend dite, kurse arsimi të bëhet pjesë e një strategjie nacionale më të gjerë për promovimin e integritit gjatë ndërtimit të një shoqërie multietnike.

Gjendja dhe shqetësimi i këtyre ekzistojnë akoma sot. Përveç kësaj, në mesin e nxënëseve shpeshherë shfaqen tensione ndëretnike. Megjithatë ka komuna që promovojnë aktivitete që synojnë integrim ndëretnik sa më të mirë, kurse disa prej tyre kanë projekte të suksesshme.

Duke pasur parasysh ç'u tha më lart, Këshilli Rinor vendosi që në pyetësinorin e kësaj strategjie ta hulumtojë edhe këtë temë. Komuna e Kërçovës është komunë multietnike në të cilën jetojnë më shumë bashkësi etnike. Deri në vitin 2016 në Komunën e Kërçovës kishte dy gjuhë zyrtare: gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe. Më 30 qershor 2016 gjuha turke u bë gjuhë zyrtare e tretë. Me këtë Komuna e Kërçovës jep një sinjal për opinionin, por edhe për qytetarët e saj, se dëshiron të ndërtojë një komunë multietnike me të drejta të barabarta për të gjitha komunitetet që jetojnë në të.

Integrimi ndëretnik është çështje shumë e rëndësishme për një mjedis si Komuna e Kërçovës dhe për të rinjtë e kësaj komune që çdo ditë kalojnë kohën së bashku. Prandaj është e nevojshme që kjo temë të zërë vend të posaçëm në këtë strategji me që aktivitete të kësaj fushë vlejnjë për gjithë të rinjtë. Imazhi i përgjithshëm i fituar nga të dhënat e hulumtimit është ky: të rinjtë shoqërohen bashkë dhe realizojnë aktivitete të përbashkëta. Rreth 82,1% e të rinjve të kësaj komunë u përgjigjen se të rinjtë shoqërohen dhe kanë miq të komuniteteve të tjera etnike. Gjatë procesit arsimor në shkollat apo fakultete, të rinjtë e komuniteteve etnike të ndryshme realizojnë aktivitete të përbashkëta. Integrimi ndëretnik vazhdon edhe gjatë realizimit të aktiviteteve të shoqatave qytetare që punojnë në fushën e arsimit joformal. Nga e gjithë kjo mund të vërehet se të rinjtë e kalojnë së bashku edhe kohën në shkollë, edhe atë në fakultet, përfshirë këtu edhe kohën e kaluar jashtë institucioneve arsimore. Kjo është një mundësi e madhe për Këshillin Rinor të Komunës së Kërçovës, si dhe për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga kjo strategji. Në përgjigjet e dhëna për këtë fushë, mes të rinjve nga komunitetet e ndryshme etnike shqetëson prania e gjuhës së urrejtjes. Nga përgjigjet e dhëna në pyetësor mund të përfundohet se: ndonëse të rinjtë konsiderojnë

29 Recommendations on Promoting Integration through Education OSCE Office of the High Commissioner on National Minorities, 25.01.2008.

se kalojnë një pjesë të kohës së lirë me miqtë nga grupet e tjera etnike, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës si organ përfaqësues i të rinjve ka ende hapësirë për të punuar dhe për ta avancuar gjendjen aktuale të integritimit ndëretnik në këtë komunë. Kjo situatë tregon se, ndonëse shoqërohen bashkë, të rinjtë përdorin gjuhën e urrejtjes të bazuar në përkatësinë etnike.

Të rinjtë e Komunës së Kërçovës kalojnë bashkë kohën e tyre të lirë pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, por edhe përkundër kësaj, përdorin edhe gjuhën e urrejtjes. Këtë fenomen Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës mund ta analizojë më tej për t'u informuar si përdoret gjuha e urrejtjes dhe nëse ajo shkakton gjëra tjera të padëshirueshme për të rinjtë. Ndonëse është e nevojshme të mësohet çfarë e nxit dhe cilat janë arsyt pse përdoret ajo, në vitet e ardhshme Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës nëpërmjet edukimit për të, do të ndihmojë zvogëlimin ose zhdukjen e saj. Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës, i përbërë nga anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, është një shembull i suksesshëm si arrihet qëllimi kur të rinjtë bëhen bashkë për të përmirësuar gjendjen e tyre. Përveç edukimit të të rinjve, në nivel lokal Këshilli Rinor do të realizojë aktivitete që do të promovojnë integritimin ndëretnik të të rinjve për ç'rënjosjen e gjuhës së urrejtjes.

Aktivitetet që do t'i realizojë Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të jenë në pajtim me planet vepruese vjetore të cilat do t'i përgatisë dhe do të realizohen së bashku me përfaqësuesit e shoqatave qytetare në nivel lokal, përfaqësuesit e institucioneve vendore, me institucionet arsimore si dhe me komisionet e posaçme brenda komunës që merren me këto çështje. Me këto aktivitete Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të synojë t'i përfshijë të rinjtë e grupeve të ndryshme (nxënësit e shkollave të mesme, studentët, të papunët) që t'i arrijë objektivat e veta.

Gjithashtu Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të përqipet të marrë pjesë dhe të jetë pjesë e përgatitjes dhe zbatimit të të gjitha dokumenteve strategjike në nivel lokal dhe kombëtar, dokumente këto që lidhen me këto çështje.



PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E INTEGRIMIT NDËRETNIK

- Rritja e vetëdijes dhe njohurive të të rinjve të përkatësive etnike të ndryshme për dëmet që sjell përdorimi i gjuhës së urrejtjes;
- Shtimi i aktiviteteve që promovojnë dhe edukojnë për integrimin ndëretnik dhe bashkëjetesën e të rinjve të bashkësive etnike të ndryshme.

FUSHA: INFORMIMI I TË RINJVE

Kur flitet dhe analizohet gjendja e informimit të të rinjve, zakonisht në mendje kemi aktivitetet dhe informacionet që duhet t'iu ofrohen të cilat janë në interesin e tyre. Në këtë proces është shumë e rëndësishme të rinjve t'iu përcillen informata cilësore të cilat mund t'iu ndihmojnë për sjelljen e vendimeve të drejta dhe për kryerjen e detyrave të tyre. Informimi i të rinjve përfshin shumë aktivitete, media, si dhe institucione të cilat duhet të marrin pjesë në procesin e komunikimit mes institucioneve dhe të rinjve edhe anasjelltas, por edhe mes vetë të rinjve. Pikërisht për këtë arsye kjo fushë është e ndërlikuar.

Në vendet e BE-së ka qendra të informimit rinor, qëllimi kryesor i të cilave është mbledhja dhe shpërndarja e informacioneve si dhe këshillimi i të rinjve për tema të ndryshme të jetës së tyre. Qendrat e informimit rinor janë organizata joftimprurëse që veprojnë për interesin e të rinjve. Funkzionimi i qendrave të informimit rinor mundëson informimin e të rinjve për vende të lira të punës, për vullnetarizëm, për institucione dhe organizata arsimore, rekreative ose kulturore, për plotësimin e të drejtave sociale, për lëvizje (mobilitet), për trajnime të ndryshme, për rikualifikim, për udhëtime, për shpërblime sportive etj. Ky sistem i informimit rinor për herë të parë është zbatuar në disa vende të BE-së në fillim të viteve '60 dhe sot praktikohet në më shumë se 30 vende evropiane³⁰.


Në fushën e informimit rinor të rinjtë kanë në dispozicion shërbime profesionale, institucione dhe burime të tjera të informimit, të cilat nuk janë të mjaftueshme. Sa i takon situatës te ne, mund të konstatohet se të rinjtë tanë nuk janë të informuar sa duhet, e kjo mund të shihet edhe në analizat e mëparshme të çështjeve të ndryshme (shëndeti, të drejtat sociale dhe dobitë). Nuk ekzistojnë qendra apo institucione ku të rinjtë do të mund të merrnin informacione të ndryshme në një vend të vetëm. Nuk ka as organizata që këto informata t'i sistemojnë, t'i redaktojnë dhe t'ua përshtatin të rinjve. Nuk ka vende ku të rinjtë do të informohen më gjerësisht për temat pa komplikime dhe procedura të veçanta ose për të marrë këshilla apo udhëzime se ku do të mund të merrnin informatat e duhura. Duke pasur parasysh faktin se jemi shtet multietnik, një nga sfidat për informimin rinor është edhe gjuha në të cilën gjenden dhe barten. Sa u takon mediave të informimit, interneti është në vendin e parë. Përqindja me e madhe e të rinjve (76%) përdorin internetin dhe lexojnë lajme elektronike çdo ditë (75%), kurse

30 Analiza për informim rinor, Strategjia nacionale për të rinj 2016-2025; mund ta lexoni në www.strategjazamladi.mk

67% përdorin internet nga telefoni celular. Në vend të dytë janë mediat televizive me 58% dhe dëgjimi i radios me 40%. Sa u përket mediave të shkruara, 14% e të rinjve nuk lexojnë asnjëherë shtypin, kurse 13% nuk lexojnë libra. Nëse shqyrtohen dallimet demografike, vërehet se të anketuarit femra lexojnë më shumë libra, kurse meshkujt luajnë më shumë video dhe lojëra kompjuterike³¹.

Sipas hulumtimit të ISSP-së³², për trendet rinore, media parësore ose kanali absolut i komunikimit i cili përdoret çdo ditë nga katër të pestat (80%) e të anketuarve është interneti. **Televizioni** është media që “përdoret çdo ditë” gati nga dy të tretat (59,5%) e të anketuarve, dhe “shpesh” para “ekranit” janë pak më shumë se një e pestë (22,9%) e të anketuarve. Shumica e të anketuarve dëgjojnë **radio** herë pas here – 39,5% ose shpeshherë – 23,3%. Siç u tha më lart, **gazetat** janë media që përdoret më pak, përkatësisht 34,1% e të rinjve nuk lexojnë aspak gazeta. Sa u takon përmbajtjeve për të cilat duan të informohen, në radhë të parë është zbatimja, informacionet për muzikën, filmat dhe ngjarjet sportive, e me pas, më pak “të rëndësishme” janë temat e interesit publik, përmbajtjet për ngjarjet politike dhe ekonomike, pra përmbajtjet me natyrë “të vështirë” kulturore-artistike apo arsimore.

Nga hulumtimi del se shumica e të anketuarve apo më shumë se dy të tretat të tyre, janë të mendimit se mediat kanë informata të mjaftueshme për temat që iu interesojnë. Ndryshe nga kjo, një e treta e të anketuarve e kritikojnë cilësinë e tyre: 27,4% e të anketuarve “janë të pakënaqur” dhe 4,1% e të anketuarve “plotësisht të pakënaqur” me cilësinë e informatave që i gjejnë në media dhe që lidhen me temat apo problemet që u interesojnë.



Përfundimet e prezantuara tregojnë se kanalet kryesore apo dominuese të komunikimit që përdor përditë e gjithë popullata janë interneti dhe televizionet. Nga ana tjetër, shumica e të anketuarve përdorin rrallë ose aspak radion ose gazetatat.

31 “Raporti nacional për Maqedoninë nga hulumtimi: “Të rinjtë dhe mediat”, Ignatova E., Xhambaska D., Bozhinovska M., Bozhoviç S., 2014.

32 “Trendet e të rinjve në Republikën e Maqedonisë”, Instituti i Hulumtimeve Sociologjike dhe Politikojuridike, dhjetor 2014.

Pikërisht për arsyt e mësipërme fusha e informimit rinor ka pjesë të posaçme si në pyetësor, ashtu edhe në strategjinë rinore. Në këtë fushë çdoherë ka hapësirë që informimi rinor të përmirësohet me informata të reja që do ta avancojnë cilësinë e jetesës, por edhe realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të rinjve. Në këtë pjesë të hulumtimit janë përfshirë tema të ndryshme për të vlerësuar nivelin e informimit rinor. Nga kjo u përfundua se të rinjtë janë të informuar pak për punën e institucioneve lokale. Ky qëndrim i tyre mund të vijë nga përfaqësimi i dobët i institucioneve në internet dhe rrjetet sociale, aty ku të rinjtë kalojnë pjesën më të madhe të jetës së përditshme, si dhe në vendet ku zakonisht informohen për të gjitha ngjarjet në komunitet. 69,9% e të anketuarve nuk janë të informuar për shërbimet që ofrojnë institucionet. Në periudhën e ardhshme në komunë do të duhet angazhim shumë më i madh i institucioneve për të gjetur rrugë si informatat që lidhen me të rinjtë të arrijnë tek ata dhe të realizohen si duhet. Nga aspekti i pushtetit lokal, të anketuarit e njohin punën e institucioneve dhe aktivitetet që i zbatojnë, ndërsa 69,7% e të rinjve janë të informuar për punën e komunës.

Të rinjtë theksuan edhe nevojën për informim rinor përkatës edhe gjatë konsultimeve publike të organizuara ngaqë mungesa e informimi sjell pasivitetin dhe mosmotivimin e tyre, e kjo pastaj çel rrugën për sfida të reja të cilat komunitetit do t'i kushtojnë shumë kohë për t'iu gjetur zgjidhje.

Sa i takon barazisë mes meshkujve dhe femrave, të anketuarit përgjigjen përgjithësisht se ajo ekziston dhe praktikohet. Femrat nga zonat rurale dhe urbane kanë të drejtat e njëjta si të rinjtë meshkuj dhe në mënyrë të barabartë mund t'i realizojnë të drejtat e tyre pohojnë 69,1% e të anketuarve. Përqindjet e të anketuarve janë të ngjashme edhe për diskriminimin e femrave në arsim, punësim dhe rritjen e pavarësisë. Pra, 48,1% e të anketuarve besojnë se ka diskriminim ndaj femrave të reja për të drejtat e përmendura më sipër, ndërsa 31,7% besojnë se ky lloj diskriminimi nuk ekziston, kurse meshkujt dhe femrat janë të barabartë në çdo fushë.

Informimi rinor duhet të ketë cilësinë më të lartë sepse nga cilësia e informatave që marrin varet zhvillimi i të gjitha temave dhe fushave të tjera. Informatat e duhura që marrin u mundësojnë avancimin dhe realizimin e të drejtave e tyre. Pra, nëse të rinjtë janë të informuar për mundësitë për punësim dhe vetëpunësim, do të dinë t'i përdorin këto të drejta; po kjo vlen edhe për të drejtat e sigurimit shëndetësor. Mungesa e informatave sjell neglizhencë dhe ndonjëherë edhe keqpërdorimin e të drejtave. Prandaj kjo temë është shumë e rëndësishme për Këshillin Rinor të Komunës së Kërçovës. Informimi dhe edukimi më i mirë janë pjesë e rekomandimeve të secilës fushë të kësaj strategjie. Këtë synon edhe Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës, pra informim më të mirë të të rinjve për secilën fushë, sidomos informimi për punën e tyre dhe atë të Komunës. Në periudhën e ardhshme Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të merret edhe me rritjen e aksesit të të rinjve tek informatat që japin institucionet e tjera lokale.

Përveç kësaj, Këshilli Rinor mund të zbatojë aktivitete për grumbullimin e informatave nga institucionet përkatëse dhe pozicionimin e Këshillit Rinor si organ i cili do t'i informojë të rinjtë. Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës në fillim duhet të luajë rolin e institucionit që shërben për informimin e të rinjtë, deri në momentin kur institucionet do të nisin t'i shpërndajnë vetë informatat për ta.

Për realizimin e të gjithë aktiviteteve që do të jenë pjesë e planeve aksionare vjetore, që të mund t'i informojë të rinjtë, Këshilli Rinor duhet të bashkëpunojë me të gjitha institucionet në nivel lokal, si dhe me institucione në nivel qendror (mundësitë për punësim dhe vetëpunësim, të drejtat në arsim, të drejtat dhe dobritë shëndetësore, mundësia për realizimin e të drejtave personale etj).



PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E INFORMIMIT TË TË RINJVE

- Rritja e informimit rinor dhe bashkëpunimi me të rinjtë nga Komuna e Kërçovës lidhur me punën e Komunës;
- Rritja e informimit rinor dhe bashkëpunimi i të rinjve nga Komuna e Kërçovës me institucionet e pushtetit lokal dhe atij qendror;
- Rritja e informimit rinor për të drejtat e tyre.

FUSHA: PJESËMARRJA E TË RINJVE

Pjesëmarrja e të rinjve do të thotë pjesëmarrja e tyre në të gjitha proceset e krijimit, vendimmarrjes dhe vlerësimit të politikave që lidhen me ta dhe janë në interesin e tyre. Kjo u jep mundësi institucioneve bartës të vendimeve t'i përfshijnë të rinjtë dhe ta dëgjojnë mendimin e atyre për të cilët i miratojnë ato politika. Mirëpo pjesëmarrja aktive nuk nënkupton vetëm përfshirjen në aktivitete përkatëse, por është një proces gjatë të cilit të rinjtë identifikojnë nevojat e tyre, kërkojnë zgjidhje, planifikojnë dhe realizojnë aktivitete, gjithnjë duke pasur mundësinë të sjellin vendime në komunitete e tyre dhe në shoqëri në tërësi. Pjesëmarrja e të rinjve nuk i referohet vetëm bashkëpunimit mes të rinjve dhe institucioneve, por edhe pjesëmarrjes së tyre në sektorin civil, si dhe në format e ndryshme të grupimit të organizuar gjatë procesit arsimor dhe në shoqatat rinore. Ka shumë mënyra si të rinjtë mund të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështje që janë të rëndësishme për ta dhe për tërë shoqërinë. Format më të shpeshta të pjesëmarrjes së të rinjve që takohen në shoqëritë bashkëkohore evropiane janë:

- Puna vullnetare;
- Pjesëmarrja në forma të ndryshme të arsimit joformal;
- Edukimi bashkëmoshatar - përfshirja e të rinjve në edukimin e moshatarëve të tyre;
- Këshillat, parlamentet, forumet dhe struktura të tjera - një mënyrë tradicionale për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në kuadër të autoriteteve ndërkombëtare, kombëtare, rajonale apo lokale, shkolla, klube, OJQ etj;
- Sistemet e bashkëmenaxhimit që ekzistojnë në disa institucione (p.sh.: Drejtoria e Rinisë dhe e Sportit e Këshillit të Evropës), ku vendimet sillen së bashku në mënyrë të barabartë me përfaqësues të të rinjve dhe përfaqësues të pushtetit;
- Konsultimet – përdoren në procesin e vendimmarrjes për të shprehur shqetësimet dhe nevojat e të rinjve si dhe për të bërë propozime.

Pjesëmarrja e të rinjve në institucione nuk është e kënaqshme dhe atje ku janë të përfshirë, rrallëherë marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes. Në nivel lokal në disa komuna vërehen forma të organizimit rinor si dhe dokumente strategjike për të rinjtë, por nuk ekziston qasje e unifikuar e cila praktikohet gjithkund. Edhe në nivel nacional

mungon dialogu dhe kanalet e komunikimit mes institucioneve dhe të rinjve ose organizatave rinore ndonëse sektori qytetar u përpoq të krijojë organe përfaqësuese për interesat e të rinjve. Përveç kësaj, qeveritë lokale dhe institucionet qeveritare nuk ndajnë fonde të mjaftueshme për nevojat e të rinjve e as për realizimin e ideve të tyre. Ato kontribuojnë shumë pak për stimulimin e vullnetarizmit mes të rinjve ndonëse pjesa më e madhe e popullatës së re e mbështet këtë angazhim si përgatitje e tyre për vendet e tyre të ardhshme të punës³³.

Viteve të fundit te ne është aktualizuar pjesëmarrja e të rinjve në nivel lokal, pra formimi i këshillave rinorë lokalë përmes bashkëpunimit të ndërsjellë mes shoqatave qytetare dhe pushtetit lokal. I tillë ishte edhe procesi i formimit të Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës. Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës përbëhet nga përfaqësues të organizatave rinore në territorin e Komunës së Kërçovës. Në vitin 2013 Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me Forumin Rinor të Arsimit dhe Qendrën e Dialogut Ndërkulturor filluan aktivitete për themelimin e një këshilli rinor në Komunën e Kërçovës që do t'i përfaqësojë dhe do t'i mbrojë interesat e të rinjve. Kërçova ishte ndër komunat e para që filluan këtë proces në interes të popullatës së re. Themelimi i Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës u realizua pas një procesi publik dhe transparent afatgjatë që u ndoq me interes dhe në të cilin morën pjesë të rinjtë, përfaqësuesit e OJQ-ve rinore si dhe përfaqësuesit e forumeve rinore të partive politike të komunës. Rezultati përfundimtar i gjithë këtij procesi ishte themelimi i Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës, i miratuar për të qenë organ formal i Komunës së Kërçovës, për të qenë më të saktë, si organ këshillëdhënës i komunës për çështjet rinore. Ai përbëhet nga 11 anëtarë, tetë prej të cilëve janë nga sektori civil, një përfaqësues i Unionit të Nxënësve të Shkollave të Mesme, një nga Unioni i Studentëve dhe një përfaqësues nga administrata komunale, i emëruar nga kryetari i Komunës për të qenë koordinator i Këshillit Rinor. Të gjithë u përzgjedhën pas hapjes së shpalljes publike nga Komuna e Kërçovës dhe pas propozimit të bërë nga komisioni përkatës në kuadër të Këshillit Komunal të Kërçovës. Mandati i tij është 2-vjeçar. Këshilli Rinor u themelua nga Këshilli Komunal i Kërçovës në seancën e mbajtur më 18.6.2015.

Pas themelimit të Këshillit Rinor, Komuna e Kërçovës në bashkëpunim me OSBE-në gjatë gjithë vitit 2015 vazhdoi të ndërtojë kapacitetet e përbërjes së parë të Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës. Bashkëpunimi dhe mbështetja nga OSBE-ja ka vazhduar edhe në vitin 2016, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve dhe proceseve të përbashkëta, siç ishte përgatitja e Strategjisë Rinore të Komunës së Kërçovës.

Përveç Këshillit Rinor, në Komunën e Kërçovës ekzistojnë edhe organizata rinore që janë pjesë e proceseve arsimore, siç janë parlamentet studentore dhe bashkësitë

33 "Nevojat e të rinjve dhe organizatat rinore në Republikën e Maqedonisë", Koalicioni i organizatave rinore SEGA, nëntor 2010.

e gjimnazistëve, por edhe shoqata rinore të tjera: shoqata kulturore-artistike dhe përfaqësues të forumeve rinore të partive politike, si forma të posaçme të organizimit dhe angazhimit rinor. Të gjitha këto forma organizimi rinor janë një mundësi që të rinjtë nga Komuna e Kërçovës të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të jenë aktivë drejtpërdrejt gjatë krijimit të politikave me interes për ta. Kjo është arsyeja pse Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës e ka hulumtuar këtë temë që përputhet me nevojat e të rinjve. Sa i takon kësaj teme, pyetësori përmbante pyetje për aktivitetet e ardhshme të institucioneve dhe të rinjve.

Përveç kësaj, pyetësori ishte mundësi për të rinjtë të japin propozime për aktivitete të ardhshme të Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës. 80% e të rinjve janë të mendimit se Komuna e Kërçovës duhet një herë në muaj të organizojë takime të hapura për të rinjtë që ata të njihen më mirë me punën e saj. Në takimet e tilla të rinjtë gjithashtu do të kenë mundësi t'i prezantojnë drejtpërdrejt problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen, si dhe të angazhohen për zgjidhjen e tyre. Përveç kësaj, këto takime të hapura do të rritin bashkëpunimin mes të rinjve dhe Komunës, si dhe besimin e tyre te pushteti lokal. Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës në periudhën e ardhshme do të angazhohet të nisë organizimi i këtyre takimeve të hapura dhe numri i tyre të rritet nga viti në vit. Këto aktivitete do të realizohen në bashkëpunim me Këshillin Komunal dhe gjithë administratën komunale.

Që të rritet pjesëmarrja e të rinjve në nivel lokal, të rinjtë janë të mendimit se në të ardhmen duhet t'i konsultojnë për të gjitha temat që janë pjesë e punës së Komunës. 84% e të rinjve në Kërçovë besojnë se Komuna duhet të takohet një herë në vit me të rinjtë në mënyrë që ata të marrin pjesë në përcaktimin e prioriteteve të ardhshme të Komunës. Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të angazhohet të sjellë një praktikë pune të tillë ngaqë ajo do të jetë një mundësi e shkëlqyer që të rinjtë të fillojnë të mendojnë për çështjet dhe sfidat më të rëndësishme dhe t'ia prezantojnë Komunës, në mënyrë që të përmirësohet gjendja aktuale. Përveç kësaj, pjesëmarrja e të rinjve në punën e Komunës do ta bëjë atë më transparente dhe më të hapur, duke i dhënë asaj një fuqi ndryshe dhe ide të reja pikërisht nga ata që duhet të vazhdojnë të jetojnë në atë komunë, duke e kthyer atë në një vend të mirë jetese që i plotëson nevojat e të gjithëve. Në këtë mënyrë, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të ndërtojë së bashku me Komunën gjenerata aktive dhe të përgjegjshme.

Për sa i përket transparencës dhe punës së Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës, të rinjtë që u përgjigjën në këtë pjesë të pyetësorit thanë se është e nevojshme që mbledhjet e Këshillit Rinor të hapen edhe për të rinjtë e tjerë që shprehin interes. Prandaj Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të përpiket që datat e mbledhjeve t'i bëjë publike dhe t'i informojë të rinjtë e interesuar për të marrë pjesë në to. Zbatimi i kësaj praktike pune do t'u mundësojë të rinjve të interesohen për punën e Këshillit Rinor dhe të përfshihen në zbatimin e aktiviteteve të tij. Në këtë mënyrë do të rritet

ndërgjegjësimi i të rinjve për të drejtat e tyre dhe aktivitetet rinore, si dhe pjesëmarrja e tyre në krijimin dhe zbatimin e politikave.

Përveç pjesëmarrjes së lartpërmendur të të rinjve gjatë krijimit dhe zbatimit të politikave rinore lokale, duke vepruar si partner i Komunës së Kërçovës, të rinjtë që ishin pjesë e konsultimeve publike theksuan nevojën edhe për ekzistimin e më shumë shoqatave rinore që do të trajtonin problemet dhe nevojat e tyre. Të rinjtë besojnë se po të kenë në dispozicionin e tyre më shumë shoqata rinore në të cilat do të angazhohen, do ta përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre, do të kontribuojnë për informimin sa më të mirë të të rinjve dhe për njohjen sa më të mirë të të drejtave të tyre dhe shndërrimin e tyre në qytetarë aktivë. Po sipas të rinjve, shoqatat qytetare me metodat e tyre të arsimit joformal (trajnime, seminare, fushata) do të mund të kontribuojnë për uljen e gjuhës së urrejtjes që përdoret akoma.



PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E PJESËMARRJES SË TË RINJVE

- Transparencë dhe qasje më e madhe tek organet komunale nga të rinjtë e Komunës së Kërçovës;
- Themelimi i kanaleve të komunikimit të rregullt mes të rinjve dhe Komunës;
- Praktikimi i kanaleve të ndryshme dhe mediave për konsultimin e të rinjve nga Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës;
- Rritja e pjesëmarrjes demokratike të të rinjve në sjelljen e vendimeve në procesin arsimor;
- Mbështetja dhe promovimi i aktiviteteve të shoqatave qytetare rinore.

FUSHA: URBANIZMI

Fusha e urbanizmit si pjesë e kësaj strategjie rinore përfshin një sërë temash të infrastrukturës ekzistuese në nivel lokal, të nevojshme për të rinjtë. Ka pyetje edhe nga fusha e ekologjisë, infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuar si dhe për parakushtet themelore për një jetë normale për të rinjtë. Kur përmendet infrastruktura dhe urbanizmi me siguri mendohet për mundësitë dhe nevojat e ndryshme që kanë të rinjtë. Para se gjithash ky term përfshin infrastrukturën e institucioneve arsimore. Institucionet arsimore përkatëse kontribuojnë për arsim përkatës dhe më cilësor. Kjo ishte një nga sfidat e komunave gjatë procesit të decentralizimit të arsimit³⁴. Për më tepër, për realizimin e të gjitha nevojave të tyre në fushën e sportit, për një kohë të lirë sa më cilësore dhe të kaluar mirë, të rinjtë kanë nevojë për një infrastrukturë të përshatshme. Në këtë fushë është shumë e rëndësishme mënyra se si të rinjtë e komunës bashkëveprojnë me të rinjtë e komunave dhe të mjediseve tjera.

Sipas të dhënave nga pyetëtori, të rinjtë e Komunës së Kërçovës i shqetëson shumë mungesa e korsive për biçikleta. Këtë përgjigje e kanë dhënë 76% e të rinjve që kanë nevojë për to. Më tej, 51% e të rinjve mendojnë se komuna e tyre ka infrastrukturë lidhëse të dobët me qytetet dhe komunat e tjera. Infrastruktura lidhëse e mirë mes komunave është e nevojshme për zhvillimin e shoqërisë, shkëmbimin e përvojave të mira dhe avancimin e pozitës së të rinjve. Prandaj është e nevojshme që në periudhën e ardhshme t'i përkushtohemi përmirësimit të kësaj gjendjeje.

Ndriçimi i komunës është kusht parësor që të rinjtë, por edhe qytetarët e tjerë të lëvizin normalisht dhe të mund t'i kryejnë nevojat e tyre në orët e mbrëmjes. Sa i takon kësaj çështjeje, 50% e të rinjve mendojnë se Komuna e Kërçovës në të gjitha pjesët është e ndriçuar mirë, përkundër 41,9% e të rinjve që besojnë se ndriçimi nuk është i mirë dhe mund të përmirësohet. Duke pasur parasysh se shumica e proceseve formale arsimore zhvillohen në periudhën nga mëngjesi deri në mbrëmje, në orët e mbrëmjes të rinjtë kanë mundësi të shkojnë në aktivitete kulturore, të kalojnë kohën e lirë duke u shoqëruar bashkë ose të jenë pjesë e arsimit joformal dhe të ndjekin trajnime të ndryshme. Nëse merret parasysh kjo, do ta kuptojmë më mirë rëndësinë që ka për të rinjtë e komunës ndriçimi i të gjitha pjesëve të qytetit. Përveç kësaj, ndriçimi i mirë e

³⁴ Për këtë proces mund të lexoni më shumë në fushën e arsimit.

shton ndjesinë e sigurisë dhe kjo ka një domethënie shtesë për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre.

Sa u përket të rinjve me nevoja të posaçme, 54,6% e të anketuarve u përgjigjën se në Komunën e Kërçovës ka kushte (në institucione, shkolla, fakultete, rrugë) për lëvizjen dhe për një jetë normale të të rinjve me nevoja të posaçme. Kjo çështje është shumë e rëndësishme sepse trajton grup të posaçëm të rinjsh që janë të ndjeshëm, kurse të dhënat në këtë fushë janë shumë të rëndësishme. Duke pasur parasysh se kushtet infrastrukturore dhe ato themelore për një jetë normale të të rinjve me nevoja të posaçme nuk përfshijnë vetëm mundësimin e kushteve fizike por edhe programe cilësore të shfrytëzuara, mund të thuhet bindshëm se kjo fushë ka gjithmonë hapësirë për avancimin e pozitës së këtyre personave dhe përfshirjen e tyre në punën e përditshme të komunës.

Të gjitha aktivitetet e kësaj fushe që në të ardhmen mund t'i parashohë Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës varen drejtpërdrejt nga mbështetja financiare përkatëse nga Komuna dhe pushteti qendror. Meqë Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës është përfaqësues i të rinjve dhe mundësi për përmirësimin e situatës së të rinjve, ky këshill do të përpiqet gjithmonë në kuadër të Komunës dhe Këshillit Komunal të kontribuojë për ndikim sa më të madh në programimin e projekteve. Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të punojë për përgatitjen dhe mbështetjen e më shumë projekteve të pushtetit lokal dhe atij qendror për përmirësimin në çdo fushë të gjendjes së këtyre të rinjve. Përveç kësaj, Këshilli Rinor do t'i hulumtojë dhe do t'i analizojë nevojat e të rinjve për infrastrukturën e duhur, që ata të përfshihen dhe të trajtohen në planet vjetore për veprim të kësaj strategjie. Që t'i planifikojë dhe t'i zbatojë në mënyrën përkatëse aktivitetet e nevojshme, Këshilli Rinor do t'i duhet përfshirja dhe përkrahja sa më e madhe e të rinjve dhe pushtetit lokal. Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të angazhohet që këto nevoja të të rinjve të jenë pjesë e të gjitha projekteve dhe programeve, si në nivel lokal, ashtu edhe në atë qendror. Në këtë mënyrë do të kontribuojë për përmirësimin e gjendjes së tanishme.



PRIORITETI STRATEGJIK NË FUSHËN E URBANIZMIT

- Mundësimi dhe avancimi i projekteve që do të sjellin kushte më të mira për realizimin e të drejtave të të rinjve dhe për cilësinë e jetës së tyre.

FUSHA: KULTURA

Kjo fushë përfshin masa dhe aktivitete që synojnë përmirësimin e jetës kulturore-rekreative dhe ofertën kulturore për të rinjtë e vendit. Kjo fushë përfshin muzikën, teatrin, filmin, letërsinë, pikturën, skulpturën, vallen bashkëkohore etj. Edhe pse kjo fushë ka spektër të gjerë, kur bëhet fjalë për të rinjtë, të dhënat për të janë të pakta ose të aspakta. Ndonëse ka dokumente dhe projekte strategjike që realizohen në nivel nacional dhe lokal, të rinjtë nuk janë objektivi i tyre. Institucioni kompetent për zbatimin e aktiviteteve, dokumenteve strategjike dhe projekteve të kësaj fushe është Ministria e Kulturës. Në "Strategjinë kombëtare për zhvillimin e kulturës 2013-2017" të rinjtë përmenden disa herë, kurse fokusi kryesor është pjesëmarrja e tyre në institucionet kulturore; analiza e nevojave të të rinjve në fushën e kulturës; krijimi i kushteve për arsimimin e duhur të kuadrove të reja të talentuara; stimulimi i krijimtarisë autoriale të artistëve të rinj. Ajo që bie në sy për këtë fushë është se ka komuna që nuk kanë kushte infrastrukturore që të realizojnë ndonjë eveniment kulturor (kinema ose teatër).

Teatro profesionalë/Professional theatres											
	Gjithsej Total theatres		Shfaqe Performances		Vizitor Attendance		Të punësuar ¹⁾ Employees ¹⁾				
	Vepra të interpretuara Performed titles		Gjithsej Total	Të ftuar Guest appearance	Gjithsej Total	Të ftuar Guest appearance	Gjithsej Total	Femra Female	Artistë Artistic	Të tjerë ²⁾ Other ²⁾	
Teatro profesionalë Professional theatres											
2014/2015	17	158	1064	218	236 643	62 182	1192	508	690	502	2014/2015
2013/2014	18	137	1008	196	207 115	59 436	1092	450	654	438	2013/2014
2014/2015 ----- 2013/2014	94.4	115.3	105.6	111.2	114.3	104.6	109.2	112.9	105.5	114.6	2014/2015 ----- 2013/2014
Shkup	7	74	501	96	142 959	34 873	764	362	462	302	Skopje
Manastir	3	21	223	50	36 344	8 319	94	35	62	32	Bitola
Veles	1	7	25	11	8 143	3 500	44	17	23	21	Veles
Kumanovë	1	10	52	9	6 938	2 750	53	19	33	20	Kumanovo
Ohër	1	5	63	9	6 855	1 310	33	14	12	21	Ohrid
Prilep	1	12	75	16	16 510	5 890	44	17	24	20	Prilep
Strumicë	1	6	38	9	4 770	1 670	54	15	20	34	Strumitsa
Tetovë	1	15	15	5	4 960	2 130	49	8	26	23	Tetovo
Shtip	1	8	72	13	9 164	1 740	57	21	28	29	Shtip
Teatro profesionalë për fëmijë dhe të rinj Professional youth and childrens theatres											
2014/2015	2	26	203	13	23 001	3 221	64	32	47	17	2014/2015
2013/2014	2	24	212	31	24 746	6 490	64	30	45	19	2013/2014
2014/2015 ----- 2013/2014	100.0	108.3	95.8	41.9	92.9	49.6	100.0	106.7	104.4	89.5	2014/2015 ----- 2013/2014
Shkup	1	21	166	12	16 901	3 021	36	18	19	17	Skopje
Manastir	1	5	37	1	6 100	200	28	14	28	-	Bitola

35

35 Të dhënat e tabelave janë nxjerrë nga Enti Shtetëror i Statistikave; për më shumë, lexoni në faqen www.stat.gov.mk

Nga këto të dhëna mund të shihet se Komuna e Kërçovës nuk ndodhet në asnjërin prej tabelave, nga ku del se kjo komunë nuk ka infrastrukturë të nevojshme që të rinjtë të vizitojnë teatër apo kinema. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, Komuna e Kërçovës ka vetëm "teatro amatorë".

T-02: Teatro amatorë 2014/2015
T-02: Amateur theatres 2014/2015

	Teatro amatorë gjithsej Total amateur theatres	Vepra të interpretuara Performed titles	Shfaqje Performances		Vizitorë Attendance		Anëtarë aktivë Active members		
			Gjithsej Total	Të ftuar Guest appearance	Gjithsej Total	Të ftuar Guest appearance	Gjithsej Total	Femra Female	
2014/2015	8	18	74	22	15 937	4 020	123	64	2014/2015
2013/2014	8	24	93	14	17 252	2 370	148	77	2013/2014
2014/2015 ----- 2013/2014	100.0	75.0	79.6	157.1	92.4	169.6	83.1	83.1	2014/2015 ----- 2013/2014
Demir Kapija	1	2	19	15	2 840	2 220	22	10	Demir Kapija
Koçani	1	2	8	-	1 396	-	1	1	Koçani
Kërçovë	1	1	3	1	1 400	400	17	5	Kiçevo
Kavadar	1	2	17	2	4 200	500	15	5	Kavadartsi
Negotinë	1	1	2	2	820	820	6	1	Negotino
Makedonski brod	1	3	5	2	503	80	6	4	Makedonski Brod
Sveti Nikole	1	1	10	-	2 400	-	20	13	Sveti Nikole
Strugë	1	6	10	-	2 378	-	36	25	Struga

Nisur nga këto të dhëna dhe nga analizat krahasuese të hulumtimeve të realizuara më parë³⁶ nga fusha e kulturës në komunat tjera, del se të rinjtë nuk i vizitojnë manifestimet kulturore, meqë ato mungojnë ose nuk përkojnë me dëshirat e tyre (festivale, koncerte). Përveç kësaj, sipas hulumtimit “Të rinjtë dhe mediat”, 34% e të rinjve të vendit nuk kanë qenë kurrë në kinema. Ky rezultat kryesisht vjen nga numri i vogël i kinemave në nivel shtetëror, pastaj edhe nga oferta e dobët e projekteve të kinemave si dhe nga mungesa e beneficioneve që iu jepen të rinjve për të shkuar në kinema ose përgjithësisht në evenimente kulturore. Mungesa e infrastrukturës përkatëse është një tregues serioz dhe i madh si i gjendjes në secilën prej komunave, ashtu edhe i realizimit të të drejtave të të rinjve në këto fusha.

Fusha e kulturës është pjesë e pyetësorit të Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës, të realizuar për nevojat e kësaj strategjie, qëllimi i të cilit ishte të dëgjohet mendimi i të rinjve për kulturën dhe ngjarjet kulturore. Të dhënat e mbledhura për këtë fushë përputhen plotësisht me infrastrukturën dhe mundësitë e ofruara aktualisht në fushën e kulturës në Kërçovë. Kështu, 79% e të rinjve të kësaj komune mendojnë se ka shumë rralë projekte filmash, ndërsa 70,4% e të rinjve mendojnë se në Komunën e Kërçovës nuk ka shfaqje teatrore. Kjo përqindje e lartë është e logjikshme nëse merren parasysh të dhënat e lartpërmendura për (mos)ekzistimin e kinemave dhe teatrove në këtë komunë.

Nocioni kulturë ndërthet edhe shumë tema të tjera përveç kinemasë dhe teatrit. Të rinjtë duan që përditshmërinë e tyre ta kalojnë në ekspozita, koncerte etj. Në çdo vend ka njerëz të rinj të cilët duan të mësojnë dhe të jenë pjesë e arsimit joformal. Nevoja të tilla kanë edhe të rinjtë e Komunës së Kërçovës. Megjithatë, rreth 76% janë përgjigjur se në këtë komunë nuk ka kurse të mjaftueshme për t’u aftësuar dhe për të përvetësuar njohuri praktike për fushat e ndryshme kulturore-artistike (orë vizatimi, leksione për instrumente muzikore, fotografi, valle etj.).

Të rinjve të Komunës së Kërçovës u duhen shumë më shumë evenimente kulturore. 75% janë përgjigjur se në Komunën e Kërçovës duhet të ketë më shumë manifestime kulturore (koncerte, ekspozita, shfaqje) për të rinjtë. Nga përgjigjet e të rinjve mund të vërehet se, ndonëse ka evenimente kulturore, nevojiten shumë më shumë. Gjatë organizimit të këtyre evenimenteve të rinjtë duhet të konsiderohen si kategori e shoqërisë që financiarisht varet akoma nga prindërit dhe se shpenzimet duhet të jenë të përshtatshme për statusin e tyre në shoqëri. Ky konstatim është rezultat i përgjigjeve të dhëna nga 59,7% e të rinjve të cilët theksojnë se biletat e manifestimeve kulturore të organizuara në komunë kanë çmime të larta dhe të papërbalueshme.

³⁶ Strategji lokale rinore; mund të lexoni në

www.sega.org.mk/web/index.php?option=com_content&view=article&id=290&Itemid=193&lang=mk

Nga realizimi i konsultimeve me këshilltarët e Komunës së Kërçovës u përmend se Komuna organizon dhe priret të organizojë ngjarje kulturore që u përgjigjen nevojave të të rinjve. Në këto ngjarje studentëve dhe nxënësve të shkollave të mesme iu lehtësohet hyrja në mënyra të ndryshme, që të rritet pjesëmarrja e tyre në këto manifestime. Interesi i të rinjve për këto ngjarje kulturore është i madh, por informimi për këto ngjarje kulturore është i vogël. Sa i takon kësaj çështjeje, duhet të përmirësohet informimi i të rinjve për ngjarjet kulturore dhe kjo do të kontribuojë për rritjen e interesit dhe vizitueshmërisë nga të rinjtë.

Duhet të ketë bashkëpunim me shoqatat qytetare dhe institucionet përkatëse që të organizohen më shumë ngjarje kulturore në të cilat do të mund të shkonin të rinjtë. Në periudhën e ardhshme Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të angazhohet të ketë më shumë ngjarje kulturore, gjithnjë duke u nisur nga infrastruktura ekzistuese, por duke synuar të ndërtohet apo të përmirësohet ajo. Në këtë fushë është e domosdoshme të merren parasysh mënyra si t'iu ofrohen të rinjve forma të ndryshme të arsimit joformal nga të cilat do të fitojnë shkathtësi nga fusha e kulturës, meqë këto nuk i fitojnë gjatë arsimit formal. Në periudhën e ardhshme Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të përgatitë aktivitete që do të jenë pjesë e planit për veprim të cilat do të kontribuojnë për avancimin e gjendjes aktuale të kulturës dhe për mundësitë që u ofrohen të rinjve.



PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E KULTURËS

- Informimi më i mirë i të rinjve për ngjarjet kulturore të organizuara në Komunë;
- Mbështetja dhe promovimi i ngjarjeve kulturore në Komunë;
- Mbështetja e shoqatave qytetare për të organizuar aktivitete të ndryshme për të fituar shkathtësi dhe dituri të natyrës kulturore-artistike.

FUSHA: SPORTI

Sporti përcaktohet me Ligjin e sportit³⁷, të miratuar në vitin 2002. Sipas këtij ligji, sporti është aktivitet që përfshin të gjitha format e veprimtarive sportive të të gjitha moshave si dhe aktivitetet sportivo-rekreative të qytetarëve.

Kuptimi më i përgjithshëm i nocionit sport lidhet me mënyrën e jetesës. Me përfshirjen e qytetarëve në sport dhe aktivitete sportivo-rekreative rrisin cilësinë e jetës së tyre në disa segmente, duke përfshirë këtu edhe arritjen e aspiratave kombëtare për rezultate të shkëlqyera ndërkombëtare në sport. Kjo e fundit vjen nga projektimi i drejtimeve për zhvillimin e sportit profesional, nga përmirësimi i sistemit kombëtar dhe shkollor të garave, nga përfshirja e të gjitha grup-moshave dhe grupeve sociale dhe nga trajtimi përkatës i problematikave të sportit, të cilat lidhen me trendet botërore dhe aktet e miratuara nga konsensuset e gjera në sferën ndërkombëtare të sportit, të pranuar dhe të ratifikuara nga vendi ynë.

Përveç Ligjit të sportit, në nivel shtetëror ka edhe Strategji për zhvillimin e sportit, një nga prioritetet më të rëndësishme të së cilës, si në nivel nacional, ashtu edhe në atë lokal, është popullarizimi i sportit mes të rinjve. Në këtë strategji është konstatuar gjendja e objekteve infrastrukturore për sport. Kështu, objektet sportive nuk i plotësojnë as standardet themelore për nevojat themelore të sportit, jo më për sport profesionist. Ndryshime të rëndësishme në këtë fushë do të arrihen nga ndërtimi i objekteve sportive, si për të rritur standardet, ashtu edhe për të krijuar kushte themelore për sport masiv³⁸.

Komuna e Kërçovës është e përfshirë në të gjitha projektet në nivel qendror që zbatohen nga Agjencia e Rinisë dhe Sportit. Këto projekte lidhen me përhapjen e sportit në nivel lokal. Komuna e Kërçovës është pjesë e një projekti për ndërtimin e 35 palestrave sportive³⁹. Në këtë komunë të rinjtë do të kenë mundësi të luajnë në sallë sportive të re. Si pjesë e këtyre projekteve, të rinjtë në Kërçovë do të kenë fusha ndihmëse për të luajtur futboll, që planifikohet të jenë pronë e komunave. Projekti për

37 Ligji i Sportit, Gazeta Zyrtare nr. 29/2002.

38 Komiteti Olimpik i Maqedonisë, "Strategjia për zhvillimin e sportit në Republikën e Maqedonisë"; mund ta lexoni në www.mok.org.mk/Default.aspx?id=7da8c558-b9c8-4d04-8c09-13624a306e63

39 Agjencia e Rinisë dhe Sportit, 35 palestra sportive; mund ta lexoni në <http://ams.gov.mk/proekti/35-sportski-sali>

fushat ndihmëse të futbollit përbëhet nga: lokacion me dimensione 120x80, me terren futbollit me dimensione 105x68 dhe objekte ndihmëse siç janë dhoma zhveshjeje, tribuna, rrjeta mbrojtëse dhe ndriçim.

Një tjetër mundësi e mirë për të rinjtë e Komunës së Kërçovës është ndërtimi i terreneve të tenisit nëpërmjet projektit "100 terrene tenisi"⁴⁰. Ashtu si në projektet e mëparshme, edhe këtu Komuna e Kërçovës është pjesë e planit me të cilin janë ndërtuar ose duhet të ndërtohen fusha tenisi për ta përhapur këtë sport.

Mënyra më e mirë për të krijuar kushte për zhvillimin e sportit për të gjithë është përmes ndërtimit të terreneve që mund të përdoren për shumë qëllime⁴¹. Terrenet e tilla do të jenë në dispozicionin e të gjithë qytetarëve për ushtrimin e sportit, rekreacionit apo garave sportive. Terrenet mund të përdoren gjithë kohën duke qenë vend takimi dhe shoqërimi i gjeneratave të reja, si dhe vendi ku do të mund të krijohej një rini e shëndetshme dhe do të parandaloheshin veset e këqija. Komuna e Kërçovës është një prej komunave pjesëmarrëse në këtë projekt.

Sidoqoftë, pavarësisht Ligjit të sportit dhe strategjive për zhvillimin e tij, nuk është e mundur që çdo individ të marrë pjesë në aktivitete sportive dhe rekreative. Veç kësaj, nuk mund të thuhet se çdo i ri ka mundësi të fitojë një formim fizik përkatës, të udhëzohet dhe të ketë mundësi të fitojë shkathtësi sportive siç janë shkathtësitë motorike, shëndeti sportiv etj. Zhvillimi i sportit dhe përfshirja e të gjithëve kërkon që të gjithë aktivitetet të zbatohen në bashkëpunim me të gjithë institucionet përgjegjëse në nivel nacional dhe lokal, dhe në bashkëpunim me sektorin qytetar.

Deri më sot nuk është bërë lidhje e sportit me edukimin e drejtpërdrejtë për sigurinë dhe shëndetin gjatë praktikimit të tij e as me higjienën e sportit, punën në ekip, përgjegjësinë, vlerat etike dhe morale, mungesën e dhunës, tolerancën apo etikën sportive. Në Ligjin e sportit të rinjtë përmenden vetëm në pjesën "kujdesi dhe mbështetja e sportit në shkolla dhe fakultete", dhe kjo është arsyeja kryesore që anashkalohen në këtë fushë⁴².

Me pyetësonin e përgatitur për këtë strategji rinore, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës hulumtoi mendimet e të rinjve për fushën e sportit. Me këtë pyetësor u hulumtuan nevojat e të rinjve në fushën e sportit ngjashëm me fushat të tjera që janë pjesë e kësaj strategjie. Kështu, 41,3% e të rinjve mendojnë se në Komunën e Kërçovës ka një numër të mjaftueshëm terrenesh sportive, ndryshe nga 41,1% e të rinjve që mendojnë se terrenet ekzistuese nuk janë të mjaftueshme dhe ka nevojë për më shumë.

Një mënyrë për zhvillimin e sportit në vendin tonë është edhe numri i klubeve sportive. Në përputhje me ligjet e vendit, klubet sportive në vend regjistrohen si

40 Agjencia e Rinisë dhe Sportit, "100 terrene tenisi" <http://ams.gov.mk/proekti/100-teniski-igralishta>

41 Agjencia e Rinisë dhe Sportit, "Terrene për më shumë përdorime"
<http://ams.gov.mk/proekti/100-povekenamenski-igralista>

42 Strategjia nacionale për të rinj 2015-2025

organizata joqeveritare, me përjashtim të klubeve sportive profesionale që janë pjesë e ligës së parë në sportin që praktikojnë. Prania e klubeve sportive në komunitet, përveç që promovon praktikimin e sportit, formon edhe frymën sportive dhe interesimin për aktivitete të tilla edhe nga ata që nuk kanë shprehur të tilla. 51,8% e të rinjve besojnë se në Komunën e Kërçovës nuk mjaftojnë klubet sportive, përkundër 36,5% e të rinjve që besojnë se numri i klubeve sportive është i mjaftueshëm.

Pas konsultimeve me këshilltarët e Komunës së Kërçovës, u theksua se Komuna e Kërçovës i përkushtohet në mënyrë të veçantë përhapjes së sportit, që të rinjtë të kenë akses në fushat sportive përkatëse varësisht nga interesat e tyre. U theksua se në krahasim me komunat e tjera, vitet e fundit Komuna e Kërçovës ka shënuar rezultate të mira të sportit në nivel lokal. Viteve të fundit komuna ka pasur shumë gara dhe klube futbollit të reja që rritin vetëdijen dhe interesimin e të rinjve për sport. Megjithatë informimi i pamjaftueshëm i të rinjve për këto ngjarje është arsyeja e pranisë së paktë të rinisë.

Jo çdo i ri dëshiron të merret me ndonjë sport (futboll, basketboll, hendboll, tenis, etj.). Shumë të rinj duan të bëjnë sport dhe të zhvillojnë shprehje sportive pa qenë pjesë e ndonjë klubi sportiv. Këtë mundësi e praktikojnë në palestra dhe qendra aerobiku të cilat nuk janë disiplina sportive, por prapëseprapë ndihmojnë për krijimin e shprehjeve sportive të të rinjtë. Mendimi i të rinjve ishte i rëndësishëm edhe për këtë lloj sporti. 53% e të rinjve kanë nevojë për më shumë palestra dhe qendra aerobiku.

Që të merren me aktivitete sportive në mënyrë adekuate, të rinjtë duhet të kenë akses më të madh në terrene sportive dhe në vendet ku mund të bëhet sport. Prandaj çmimet për të kryer aktivitete sportive janë shumë të rëndësishme, veçanërisht nëse kemi parasysh përqindjen e lartë të papunësisë së të rinjve dhe varësinë financiare nga familjet e tyre. Çmimi i aktiviteteve sportive është shumë i rëndësishëm si për praktikimin, ashtu edhe për përhapjen e tyre. 46,7% e të rinjve të Komunës së Kërçovës mendojnë se çmimet e aktiviteteve sportive janë të larta ose pothuajse të papërballueshme, përkundër 19,55% që besojnë se çmimet janë normale.

Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës në periudhën e ardhshme do të punojë për të promovuar idenë e sportit dhe aktiviteteve sportive, duke i bërë ato sa më masovike. Para së gjithash duhet të bëhet analiza përkatëse për nevojën për terrene sportive dhe infrastrukturën tjetër të nevojshme për ta praktikuar sportin, e pastaj të përgatiten aktivitetet për promovimin e tij. Këshilli Rinor do t'i përdorë mundësitë që i japin projektet e pushtetit qendror për rrijen e numrit të terreneve sportive. Përveç kësaj, në këtë fushë Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet relevante duke siguruar beneficione dhe kushte të volitshme për sportin mes të rinjve. Me aktivitetet e tilla, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës beson se në periudhën e ardhshme do t'i promovojë në mënyrën e duhur.

Gjatë përgatitjes së planeve vjetore të veprimit lidhur me këtë strategji, gjithmonë duhet të lihet e hapur mundësia të përfshihen edhe tema të tjera parësore të kësaj fushe për përmirësimin dhe promovimin e sportit në mesin e të rinjve.



PRIORITETE STRATEGJIKE NË FUSHËN E SPORTIT

- Informimi i të rinjve për të gjitha mundësitë dhe ngjarjet sportive në fushën e sportit;
- Mbështetja e të rinjve për përdorimin e të gjitha kapaciteteve sportive të Komunës;
- Promovimi i sportit mes të rinjve të Komunës së Kërçovës;
- Përgatitja dhe mbështetja e projekteve rinore që synojnë ritjen e mundësive të fushës së sportit.

PARIMET E ZBATIMIT TË STRATEGJISË RINORE DHE TË PËRGATITJES SË PLANEVE TË VEPRIMIT

Në pjesën vijuese të Strategjisë rinore të Komunës së Kërçovës janë përmendur parimet për krijimin e planeve të veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, si dhe parimet e realizimit të drejtpërdrejtë të aktiviteteve. Ky përcaktim është i nevojshëm për të identifikuar parimet e çdo fushe që do të jenë themelet e përgatitjes së aktiviteteve të ardhshme.

- **Bashkëpunimi më i mirë i të rinjve, Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës dhe Komunës**

Me këtë strategji rinore do të avancohet pozita dhe mundësitë e të rinjve për t'u ballafaquar me të gjitha sfidat, duke i bërë partner gjatë përgatitjes dhe marrjes së vendimeve për të gjitha dokumentet strategjike në nivel lokal.

- **Mundësi për të rinjtë**

Për pjesëmarrje cilësore rinore, të rinjve duhet t'u ofrohen mundësi të ndryshme që rritin cilësinë e jetës. Përdorimi i këtyre mundësive ata i bën qytetarë aktivë që marrin pjesë në krijimin dhe zbatimin e politikave publike.

- **Pjesëmarrje e të rinjve në krijimin e politikave publike**

Siç është thënë më lart, me pjesëmarrjen e të rinjve nënkuptojmë më shumë aktivitete dhe palë interesi që duhet të koordinohen dhe të punojnë për avancimin e pjesëmarrjes së të rinjve në bërjen e politikave. Sipas kësaj është e nevojshme që:

- Shoqatat qytetare ta promovojnë pjesëmarrjen e të rinjve dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet e veta;
- Të rinjtë të rritin pjesëmarrjen e tyre në institucionet dhe shoqatat qytetare në nivel lokal dhe nacional;

- Të mundësohen procese dhe aktivitete të autoriteteve lokale që do t'i përfshijnë të rinjtë në krijimin dhe zbatimin e politikave;
 - Pjesëmarrje dhe konsultimi i Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës në të gjitha çështjet që lidhen me të rinjtë e Komunës.
- **Integrimi multi-etnik dhe respektimi i shumëllojshmërisë (diversitetit)**
Aktivitetet e strategjisë synojnë t'i përfshijë të gjithë të rinjtë pa diskriminim. Të rinjtë janë kategori me nevoja të ndryshme, me prejardhje dhe sfida të llojllojshme, prandaj duhet që përgatitja dhe hartimi i planeve të veprimt t'i përfshijë të gjithë. Strategjia promovon karakterin multi-etnik të Komunës dhe të të rinjve në këtë komunitet. Zbatimi i kësaj strategjie duhet të marrë parasysh edhe përfshirjen e të gjitha bashkësive etnike, si dhe informimin e të gjithë të rinjve në gjuhën e tyre.
- **Gjetja e hapësirës dhe mbështetja për realizimin e aktiviteteve**
Strategjia rinore parashikon objektivat strategjike të Këshillit Rinor të Komunës së Kërçovës për periudhën e ardhshme, si dhe identifikimin e gjendjes aktuale të të rinjve në shoqëri. Kjo strategji do të përmbushet vetëm përmes gjetjes së hapësirës përkatëse dhe përkrahjes nga të gjitha palët në shoqëri. Shumë nga fushat e përmendura më lart kërkojnë mbështetje të vazhdueshme dhe afatgjatë, prandaj zbatimi i ideve kërkon hapësirë dhe mbështetje të domosdoshme.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Vazhdimësia e zbatimit të strategjisë, si dhe monitorimi e vlerësimi përkatës të asaj që është zbatuar, shtron nevojën për mënyrën e informimit/raportimit.

Për monitorimin dhe vlerësimin e kësaj strategjie, Këshilli Rinor rregullisht do të përgatisë plane vjetore të veprimit në përputhje me objektivat e këtij dokumenti strategjik. Këto plane do të përgatiten në konsultim me të rinjtë e Komunës së Kërçovës. Gjithashtu këto plane do të jenë dokumente publike dhe në dispozicionin e të gjithë të interesuarve.

Për zbatimin e planeve të veprimit të kësaj strategjie, çdo ditë do të përgatiten raporte që do t'i prezantohen Këshillit të Komunës së Kërçovës. Për t'u ndihmuar përpjekjeve për bashkëpunim me të rinjtë dhe informimin e tyre për aktivitetet e një periudhe të caktuar kohore, Këshilli Rinor këto raporte do t'i publikojë në kanalet e komunikimit.

Kjo strategji përkrah bashkëpunimin me shoqatat qytetare, prandaj Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të organizojë takime edhe me këto shoqata ashtu që të gjitha palët e interesit të japin mendimin e tyre për mënyrën e zbatimit të strategjisë, si dhe për hartimin e planeve të veprimit. Bashkëpunimi i tillë u mundëson shoqatave qytetare të marrin pjesë drejtpërdrejt në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e Strategjisë rinore të Komunës së Kërçovës.

Raportet dhe planet e veprimit do të publikohen rregullisht dhe do të jenë në dispozicion në faqet e internetit të Komunës. Nëse organizatat rinore janë dakord, do të kenë mundësinë që në faqet e tyre të internetit të publikohen raportet dhe planet aksionare për zbatimin e kësaj strategjie.

Vitin e fundit para mbarimit të afatit të kësaj strategjie, Këshilli Rinor i Komunës së Kërçovës do të krijojë metodologjinë dhe mënyrat përkatëse për të vlerësuar gjithë çfarë është zbatuar nga ky dokument strategjik. Përveç matjes së shkallës së zbatimit të kësaj strategjie, ky vlerësim duhet të masë edhe efektet e saj. Ky vlerësim do të duhet për përgatitjen e një dokumenti të ri strategjik, sipas nevojave dhe sfidave të të rinjve.


LITERATURA

- Kushtetuta <http://www.sobranie.mk/kushtetuta-e-rm-s.nsp>
- Ligji i arsimit të mesëm
- Ligji i arsimit të mesëm profesional
- Ligji i arsimit të lartë
- Ligji i sportit
- Strategjia nacionale për të rinj 2005-2015
- Plani veprues për zbatimin e Strategjisë nacionale për të rinj, 2009
- Strategjia nacionale për të rinj 2016-2025
- Analiza e Strategjisë nacionale për të rinj 2016-2025
- Strategjia për uljen e numrit të rasteve të dhunës në shkolla 2012-2015
- Strategjia kombëtare e punësimit, 2015
- Plani veprues për punësimin e të rinjve për vitin 2015
- Arsimi joformal në RM: gjendja dhe sfidat, Buova E., Dodovski I., MKC Manastir, 2009
- Studim për gjendjen fillestare të dhunës në shkollat fillore në Maqedoni, Qendra Algoritam, Enti për Zhvillim të Arsimit, viti 2009
- Demand for skills in FYR Macedonia, Rutkowski J., 2010
- Studim për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë, Topuzovska-Llatkoviç M., dhe të tjerë, Fondacioni Fridrih Ebert, 2013
- Raport për gjendjen e të rinjve, Instituti i Hulumtimeve Sociologjike dhe Politiko-juridike, dhjetor 2014
- Studimi për multikulturalizmin dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim, Violeta Petroska-Beshka, Mirjana Najçevska, Nikolina Kenig, Safet Ballazhi dhe Ana Tomovska, 2009
- Statement by Knut Vollebaek, OSCE High Commissioner on National Minorities, The 718th plenary meeting of the OSCE Permanent Council (2009)
- Recommendations on Promoting Integration through Education OSCE Office of the High Commissioner on National Minorities, 25.01.2008
- Raporti nacional për Maqedoninë për "Të rinjtë dhe mediat" Ignatova, Xhambaski D., Bozhinovska M., S. Bozhoviç, 2014
- Trendet e të rinjve në Republikën e Maqedonisë, Instituti i Hulumtime Sociologjike dhe Politiko-juridike, dhjetor 2014
- Nevojat rinore dhe organizimet rinore në vend, Koalicioni i organizatave rinore SEGA, nëntor 2010
- Hapat drejt arsimit të integruar në Republikën e Maqedonisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës

- Raporti vjetor për aktivitetet e zbatuara nga Këshilli Nacional për Sigurinë e Komunikacionit
- Raporti kombëtar për papunësinë e të rinjve në vend, MKC Manastir, dhjetor 2015
- Manuali i decentralizimit për përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile për monitorimin e procesit të decentralizimit në Republikën e Maqedonisë, 2013
- www.mok.org.mk
- www.ams.gov.mk
- www.beznasilstvo.mk
- www.rsbsp.gov.mk
- www.strategijazamladi.mk
- www.kupikukakupistan.gov.mk

Follow OSCE



 Misioni i OSBE-së në Shkup
Bulevard "8-mi Septemvri" nr.16
1000 Shkup

Telefon: +389 2 323 4000

Faks: + 389 2 323 4234

info-MK@osce.org